ISSN 1857-6443

Sot duhet të shpallen zgjedhjet presidenciale

Fq.3

VRASJA E NIKOLLËS

Ekspertizë e re për "Sazdovskin"

Fq.5



Njerëzit e Putinit të mbuluar me luks

Fq.13

www.koha.mk

Koha

KOHA për InfraRed

Fq.14-17

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XIII · Numri 3579 · e premte, 8 shkurt 2019 · -4°c | 4°c · 15 DEN

AKTUALE

Grekët të brengosur për brendin "Maqedonia"

Brendi "Maqedoni" shfaqet në 182 biznese greke, ndërsa mbi katër mijë kompani greke e përdorin atë në përshkrimin e të paktën një produkti, duke e bërë të paqartë se si do të vazhdojnë ta përdorin atë pas ratifikimi të Marrëveshjes së Prespës, shkruan gazeta "Kathimerini", botimi në anglisht. Oda Ekonomike në Greqinë e Veriut tashmë ka ofruar asistencë ligjore për bizneset që kërkojnë sqarime të mëtejshme të detajeve të...

Fq.6

FORUM

Kurti dhe "Pranvera" ndër shqiptarë!

Fq.12

RAJON

Nis punën në qershor qendra në Beograd

Fq.12

NË "MARIJA KIRI-SKLODOVSKA" BOJKOTOHET DREJTORI SHQIPTAR

"RACIZEM EDHE NË ARSIM"

Racizmi maqedonas u tregua edhe në arsimin e mesëm. Nxënësit maqedonas, të nxitur nga profesorët e tyre, kanë nis bojkotin e procesit mësimor në shkollës e mesme kimike "Marija Sklodovska-Kiri" pasi nuk pranojnë drejtor shqiptarë. Kryetari i Shkupit, Petre Shilegov, bëri thirrje për normalizimin e marrëdhënieve dhe procesit arsimor, ndërsa ministri Ademi tha se tensionet dhe ndarjet ndëretnike në shkolla janë të papranueshme

Fq.4

Gjysma pa tapi! Legalizimi i shtëpive ec ngadalë

Shkup, 7 shkurt - Më 31 dhjetor të viti 2018 skadoi afati për dorëzimin e kërkesave të reja për legalizimin e patundshmërive , si dhe afati për dorëzimin e dokumenteve që mungojnë, ku dominonte elaborate gjeodezik. Me fjalë të tjera pasi shteti, tre herë prej muajit mars të vitit 2011 deri më fundin e vitit të kaluar ju mundësoi qytetarëve të legalizojnë pronat e tyre, konform Ligjit për veprimin me objektet e ndërtuara pa leje, akoma një pjesë e madhe e kërkesave të qytetarëve kanë mbetur të pazgjidhura dhe qëndrojnë në sirtarët e komunave si rrjedhojë e problemeve të ndryshme administrative. Në gati tetë vitet e kaluara , mbi 210 mijë ndërtime pa leje kanë zgjidhur statusin e tyre dhe kanë fituar fletë pronësi , ndërsa mbi 440 mijë kërkesa janë parashtruar për legalizimin e trojeve...

Fq.7



ANALIZË

TRADHTIA NDAJ CHARLIE HEBDO

Elan JOURNO

Katër vjet më parë, disa xhihadistë mësynë me forcë në zyrat e revistës Charlie Hebdo në Paris, dhe qëlluan për vdekje 10 anëtarë të stafit, një oficer policie dhe një roje sigurie. Menjëherë pas masakrës, mijëra njerëz u derdhën rrugëve për të përkujtuar gazetarët e vrarë. Globalisht, në mediat sociale, shumica i bënë jehonë sloganit 'Je Suis Charlie', në shenjë solidariteti. Por kur ai moment kaloi, u bë e qartë se kërcënimi ndaj lirisë së fjalës buron jo vetëm apo kryesisht nga "vetoja" e xhihadistëve. Problemi më i thellë jemi vetë ne. Ekziston një antipati e përhapur, ndaj parimit të lirisë së shprehjes.

Nëse nuk e kuptojmë dhe e vlerësojmë, do ta humbasim këtë të drejtë vendimtare. Që nga pasojat e masakrës së Charlie Hebdo , është bërë e qartë se fjala e lirë gjendet nën kërcënim nga inteligjencia kryesore, si dhe islamikët e dhunshëm. Së pari, ka pasur reagim kundër vetë Charlie Hebdo. Ndërsa shumë njerëz shprehen solidaritet, të tjerët u morën me satirizimin e shpeshtë që revista i bënte Islamit me paraqitjen e karikaturave të Profetit Muhamed. Fjala e lirë, është e drejta për të shprehur idetë vetjake, pa frikën e ndëshkimit, edhe nëse të tjerët nuk bien dakord me ju - edhe nëse ndihen të fyer. Kjo e drejtë i lë njerëzit të lirë të kundërshtojnë, dhe të lirë të bindin të tjerët për idetë e tyre. Asnjë pikëpamje politike, fetare apo ideologjike, nuk duhet të lejohet si një përjashtim i veçantë nga sfida, kritika apo tallja. Por sapo u zbeh vrulli i fushatës 'Je Suis Charlie', zërat e shquar nisën të fajësojnë vetë revistën për sulmin.

Kur "PEN America", një organizatë e shkrimtarëve në SHBA, vendosi t'i jepte Charlie Hebdo, çmimin e Lirisë së Shprehjes dhe Kurajos, më shumë se 200 shkrimtarë të mirënjohur protestuan. Dekani i një shkolle të gazetarisë, duke shkruar në "USA Today", nënkuptonte se satirat e revistës ndaj profetit Muhamed, duhet të lihen jashtë mbrojtjes nga Amendamenti i Parë. Dhe Geri Trudo, krijuesi i ilustrimeve komike Doonesbury, sugjeroi se Charlie Hebdo kishte nxitur dhunën vrastare kundër vetes.

Refuzimi i fjalës së lirë, ka qenë gjithashtu i dukshëm në një vend tjetër në shoqëri. Debatet mbi fjalën e lirë në kampuset universitare, janë shpeshtuar që nga masakra e Charlie Hebdo. Në Berkli, studentët protestuan në vitin 2017 për të parandaluar një aktivitet, duke shkaktuar 100 mijë dollarë dëme. Në Middlebury College, studentët ndërprenë në mes një aktivitet promovues mbi shkrimtarin kontrovers, Çarls Marrej, duke plagosur një anëtar të fakultetit. Një çështje e rëndësishme në këto polemika, është pikëpamja e një numri alarmues studentësh se fjalët janë dhunë. Shumë studentë sot, mendojnë se dëgjimi i ideve që sfidojnë idetë e tyre, është i barabartë me një sulm fizik. Ata me dashje e turbullojnë vijën ndarëse midis fjalës dhe veprimit. Kjo është vërtet diçka ogurzezë, pasi legjitimon përdorimin e forcës, për të heshtur zërat me të cilët nuk pajtohemi. Sondazhet tregojnë se ndërsa pak studentë, do të ishin vetë të gatshëm të përdornin dhunën për t'i mbyllur gojën një folësi, 19-30 për qind e tyre, besojnë se është e justifikueshme që studentët e tjerë ta bëjnë diçka të tillë.

Sulmi ndaj fjalës së lirë po vjen edhe nga e djathta. Presidenti Donald Trump, jo vetëm është përplasur me mediat. Ai ka shprehur një antipati më të gjerë ndaj Amendamentit të Parë. Ai ka sugjeruar që ligjet federale mbi shpifjen duhet 'të zgjerohen", me sa duket në mënyrë që ai të ketë mundësi të përndjekë kritikët e tij. Ai gjithashtu ka kërcënuar të anulojë licencat e transmetimit, si një formë ndëshkimi për mbulimet mediatike të pafavorshme ndaj tij. Kur shohim më gjerë, atëherë është e qartë se kërcënimi ndaj fjalës së lirë, është shumë më i gjerë sesa thjesht kërcënimi xhihadist. Para se të mbështesim fjalën e lirë, ne duhet ta kuptojmë atë. Ne duhet ta vlerësojmë vlerën e saj në avancimin e jetës, njohurive dhe përparimit të njeriut. Katër vitet nga masakra në Charlie Hebdo, na kanë treguar se kemi ende shumë rrugë për të bërë.

(Spiked)



ABUZIMET DHE KËRCËNIMET TË PARAQITEN

"Jam i tronditur që një mësues që i besojmë femiun dhe një polic që i besojmë sigurinë të abuzojnë me një të mitur. Përgëzoj reagimin e shpejtë të autoriteteve komunale dhe qendrore ndaj këtyre abuzuesve. Bashkëndjejë me familjen e të abuzuares dhe i siguroj që organet e drejtësisë do të merren me rastin seriozisht. Dua t'i falënderoj mediat për angazhimin e pandalshëm që të raportojnë për raste të tilla dhe të shtyjnë reagimin institucional dhe shoqërore. Apeloj te të gjitha vajzat dhe gratë që janë cak i abuzimeve dhe kërcënimeve të kësaj natyre, të paraqesin rastet dhe të raportojnë dhunuesit", ka shkruar një status në Facebook, kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Hardinaj.



DANIEL SERWER THUMBON THAÇIN

Njohësi i çështjeve të Ballkanit, Daniel Serwer ka thumbuar presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi kur kishte njoftuar se do të fliste para një audience të specialistëve të rajonit në "Council of Foreign Relation" në Washington. "Do të flas në CFR për angazhimet për të arritur marrëveshje paqësore mes Kosovës dhe Serbisë që do t'ia sigurojë Kosovës ulësen në OKB dhe do të konfirmojë me kohë anëtarësinë në NATO dhe familjen e aleatëve të BE-së", ka shkruar Thaçi në gjuhën angleze në Twitter. Këtij njoftimi i është përgjigjur Serwer duke i thënë që herën tjetër ta thërrasë mikun që ia kundërshton idenë e shkëmbimit të territoreve. "Herën tjetër fto edhe miqtë që mendojnë se propozimi yt për territore është ide e keqe", ka thumbuar Serweri presidentin Thaçi.



E KEQJA QË KA MUNDUR TË PARANDALOHET

"Ne si shumicë shtiremi si gjoja të ndershëm, ndërsa jemi frikacakë. Shtiremi si gjoja indiferentë, ndërsa jemi hiporkitë. Prandaj e keqja triumfon, si në këtë rastin e dhimbshëm në Drenas. E pamundur është që të mos e kënë ditur fatkeqësinë e asaj vajze, shumë njerëz, familja, farefisi, fshati, shkolla, qyteza. Këtë mjerim njerëzor e ka markuar Markesi në romanin "Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar." Të gjithë e dinë se vëllezëri Pabllo e Perdo janë nisur që ta vrasin Santiago Nasarin, por askush nuk i tregon atij se po e kërkojnë ta vrasin. Pra, ata që nuk e denoncojnë e nuk e luftojnë të keqen, (me dorën e vet, me fjalën e vet a veç me zemren e vet) bëhen pjesëmarrës në triumfin e të keqes", ka shkruar një status në Facebook, pedagogu dhe shkrimtari Milazim Krasniqi.



MË VJEN PËR TË VJELLË KUR JU DËGJOJ TË FLISNI PËR ATDHE

"Gjithë javën dëgjoj përdhunime, shantazhe, rrahje deri në vdekje.
Varini testikujt të pragu i derës, ju dhe te gjithë ata që rrinë indiferent!
Ja pse më vjen për të vjellë kur ju dëgjoj të flisni për atdhe, patriotizëm e ide të mëdha. Arkaikë të dështuar, ju me trurin e tretur në spermë, u pshurrsha burrërinë!", ka shkruar një status në Facebook, poetja shqiptare Brikena Qama, me banim në Athinë.

MEDIACitate

NDARJA NUK SJELL PAQE DHE STABILITET

Ndryshimi i kufijve në një vend mund të nxisë për ndryshimin e kufijve të tjerë në rajon, thotë ish-ministri i Jashtëm serb Vuk Jeremiq, në një intervistë për DW.
"Nëse Presidenti i SHBA Donald Trump me memorandumin e Shtëpisë së Bardhë i dërgon letër Aleksandar Vuçiqit dhe Hashim Thaçit dhe thotë: "Tani kur jeni edhe një hap larg marrëveshjes..". atëherë unë mendoj se askush nuk e ka mashtruar Presidentin Trump, se po ndodh diçka, nëse nuk po ndodhë asgjë. Kjo është një prej dëshmive se diçka po ndodh, ndërsa ne në Serbi nuk e dimë fare se ku po ndodh dhe cila është përmbajtja e bisedimeve. Më duket se situata në Kosovë është pak më e mirë dhe se atje ka konsultime mes faktorëve të ndryshëm politikë, në dallim prej Serbisë. Mendoj se kjo nuk është rruga e mirë për arritjen e një marrëveshjeje".
"Për të arritur një zgjidhje afatgjatë gjërat nuk mund të rregullohen nga kulmi. Duhet gjetur zgjidhje nga themeli. Themeli nënkupton vendosjen e mirëbesimit për zbatimin e marrëveshjeve. Tani nuk ekziston atmosfera për aplikimin e çfarëdo marrëveshjeje. Aktorët janë të interesuar për mbajtjen e tensioneve konstante, për shkaqe të brendshme politike dhe kjo paraqitet si një armiqësi. Së pari duhet të ndryshohet atmosfera e bisedimeve. Dy, duhet kërkuar zgjidhje shumë konkrete të cilat janë parakusht për gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare. Kjo ka të bëjë me të drejtat e njeriut në hapsirat ku jetojnë, në radhë të parë për minoritetin, sepse ai është i rrezikuar në këtë moment. Gjëja tjetër që duhet bërë është definimi i statusit, mbrojtja dhe garancitë për Kishën Ortodokse serbe. Rëndësia e Kosovës për Serbië në kontekstin e identitetit është e ndërlidhur në masë të madhe me Kishën ortodokse serbe. Mendoj se është gabim të flitet tani për ndonjë zgjidhje konkrete, por është me rëndësi për gjetjen e zgjidhjes afatgjate të statusit që të ndryshojë qasja dhe të krijohet një atmosferë e mirëfilltë për negociata. E kur të dy palët përfaqësohen nga persona, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë janë angazhuar në vitet 90-të për shkallëzimin e armiqësive, atëherë vështirë të paramendosh që pikërisht ata do të flakin të kaluarën që i ngarkon, dhe të gjejnë një zgjidhje afatgjatë dhe paqë të qëndrueshme".
"Nëse vjen deri te rivizatimi i kufijve dhe përkufizimet e reja, këtë do të përpiqet ta bëjë edhe dikush tjetër në rajon. Si mund të shpjegoni një shkëmbim territoresh ku njëri grup etnik do të mbetej këndej e tjetri në anën tjetër? Nëse lejoni logjikën se kjo sjell paqe dhe stabilitet, si mund të thoni se e njëjta nuk vlen edhe 400 kilometra më larg?"
"Për mua nuk ka dielema - unë jam kundër pavarësisë. Nuk dua të flas në emër të të gjithëve, sepse tani kemi një opozitë unike dhe jemi bashkuar rreth një çështjeje, e ajo është vendosja e një Serbie normale dhe demokratike. Pas realizimit të këtij qëllimi, në kuadër të përballjes së lirë dhe demokratike, secili do të angazhohet për realizimin e ideve për Kosovën, ekonominë dhe të gjitha çështjet tjera. Ne në Serbi nuk kemi tani privilegjin e shprehjes dhe shkëmbimit të mendimeve të lira".

(DW, 7 shkurt)

Kandidati për president i LSDM-së, më 3 mars

Tetovë, 7 shkurt - Kush do të që jetë kandidat i LSDM-së për president, do të vendoset më 3 mars në Kongresin e kësaj partie. Kështu ka thënë dje ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska, gjatë qëndrimit të saj në kazermën në Tetovë, ndërsa ka shtuar se aktualisht, më shumë janë të fokusuar në çështje kryesore për shtetin.

"Vendimi do të sillet në fillim më 3 mars në Kongresin e partisë, në ndërkohë rrjedhin edhe diskutime, konsultime dhe analiza dhe jemi të fokusuar në çështjet kryesore të shtetit. Arritëm të vijmë deri tek Protokolli për anëtarësim në NATO, arritëm të zgjidhim këto pyetje kyçe dhe unë pres se do të jem ministrja e parë e Maqedonisë që do të marrë pjesë me të gjithë ministrat e Mbrojtjes të shteteve anëtare të NATO-s në një mbledhje ministrore dhe kjo është ajo ku ne e harxhojmë energjinë", tha Sheqerinska, ndërsa la të ditur se nuk do të kandidojë për president shteti. Në ndërkohë, Sheqerinska nuk ka dashur të komentojë deklaratën e kreut të BDI-së, Ali Ahmeti, i cili ditë më parë tha se nuk do të përkrah kandidat që do të dalë nga Kongresi i LSDM-së.

"Unë besoj se koalicionet janë partneritete. Kjo do të thotë se askush askujt nuk mund ti jap përkrahje 'blanko', por jo vetëm me partnerin tonë qeveritar - BDI, por edhe kjo ndodhë edhe brenda koalicionit tonë me të cilët dolëm në zgjedhje. Megjithatë, me të gjithë kemi biseda të hapura. Nuk besojmë në 'lidhje', por koalicionet dhe partneritetet janë për tu dëgjuar, për të biseduar dhe ta gjejmë më të mirën jo për qeverinë, por për shtetin" , deklaroi ajo. *(U.H)*

BASHKË ME VOTIMIN E PËRBËRJES SË TË KOMISIONIT ANTIKORRUPSION

SOT DUHET TË SHPALLEN ZGJEDHJET PRESIDENCIALE

Nga BDI-ja edhe pse thonë se kanë qëndrim zyrtar nëse në zgjedhjet mund të marrë pjesë me kandidat të tyre, megjithatë, lënë mundësi para skadimit të afatit për parashtrimin e kandidaturave për të arritur edhe një zgjidhje tjetër. BDI-ja, thotë deputeti Xhevat Ademi, është komod, ka edhe kandidatë edhe cilësi edhe opsione

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 7 shkurt - Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, dot duhet t'i shpallë zgjedhjet presidenciale, për të cilat rrethi i parë duhet të mbahet më 21 prill, ndërsa i dyti më 5 maj. Në pajtim me Kodin zgjedhor, nuk duhet të kalojnë më shumë se 90 dhe jo më pak se 70 ditë nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së tyre. Mandati i presidentit aktual, Gjorge Ivanov përfundon më 12 maj. Partitë politike deri më tani nuk kanë bërë të ditur kandidatë për zgjedhjet e ardhshme presidenciale. Dy partitë më të mëdha, LSDM-ja dhe VMRO-DPMNE-ja, kandidatët e tyre vendosën t'i zgjedhin përmes konkursit publik.

Nga LSDM-ja ende nuk kanë kumtuar nëse kanë arritur kandidatura. Sekretari i përgjithshëm, Aleksandar Kiracovski konfirmoi se procesi është në vijim dhe se në kongresin partiak më 3 mars do të jetë përzgjedhja zyrtare e kandidatit. Në konkurs, megjithatë, të VMRO-DPMNE-së kanë arritur 10 kandidatura nga të cilët njëra për skadimin e afatit, pas çka partia i publikoi emrat e kandidatëve nga të cilët në konventën më 16 shkurt do të përzgjedhin një i cili do të hyjë në garën për shef të shtetit.

Nga BDI-ja edhe pse thonë se kanë qëndrim zyrtar nëse në zgjedhjet mund të marrë pjesë me kandidat të tyre, megjithatë, lënë mundësi para skadimit të afatit për parashtrimin e kandidaturave për të arritur edhe një zgjidhje tjetër. BDI-ja, thotë deputeti Xhevat Ademi, është komod, ka edhe kandidatë edhe cilësi edhe opsione. Lidhur me mbajtjen eventuale të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare së bashku me ato presidenciale siç kërkon opozita, Kiracovski paralajmëroi se shumë shpejtë vendimi i partisë për këtë çështje do të sillet dhe do të publikohet.

Në Parlament, dje është mbledhur Komisioni për selektim, i cili ka kryer renditjen e kandidatëve për anëtarë të ardhshëm të Komisionet shtetëror për parandalim të korrupsionit, ndërsa përbërja e re e Komisionit Antikorrupsion duhet të votohet më së voni sot, që ai të mund ta ndjekë edhe këtë proces zgjedhor. Secili anëtar i Komisionit për përzgjedhje do të japë vlerësime për 57 kandidatët, të cilët i kanë kaluar intervistat. Secili kandidat mund të marrë maksimum 100 pikë. Përvoja dhe arritjet në luftën kundër korrupsionit sjellin maksimum 40 pikë, ndërsa 60 pikë kandidatët mund të marrin në bazë të asaj si janë treguar në intervistë. Pas renditjes, lista e renditjes duhet të publikohet dhe dorëzohet deri te Komisioni për zgjedhje dhe emërime i cili duhet ta konfirmojë zgjedhjen e shtatë kandidatëve me më shumë pikë të cilët do të hyjnë në përbërjen e re të anti korrupsionit, pas çfarë ata duhet të miratohen në seancë plenare. Duke marrë parasysh që anëtarët e Komisionit për Antikorrupsion duhet të votojnë me shumicë prej dy të tretave, nevojitet të arrihet marrëveshje midis partive politike. Anëtarët e rinj të Anti korrupsionit duhet të votohen në seancë plenare më së voni deri nesër sepse kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë duhet të shpallë zgjedhjet presidenciale.

Në pajtim me ingerencat e reja, Komisioni Antikorrupsion do të duhet ta monitorojë edhe procesin zgjedhor në pjesën e financimit të partive politike.

ZAEVI PRITI NË TAKOI AMBASADOREN GALLOUEJ

ANËTARËSIMI NË NATO, FITORE E MADHE

Shkup, 7 shkurt - Integrimi i Maqedonisë në NATO është fitore e madhe për shtetin sepse hapë perspektiva për përfitime të dukshme ekonomike. Mbretëria e Bashkuar planifikon në kohë të shpejtë t'i fillojë procedurat për ratifikimin e Protokollit për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në NATO.

Këtë e ceki Rejçell Gallouej, ambasadore e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, në takimin e sotëm me kryeministrin Zoran Zaev, ku ia uroi nënshkrimin e Protokollit për inkuadrim të Republikës së Maqedonisë në NATO. Siç kumtoi shërbimi qeveritar për shtyp, ajo gjithashtu, e ka inkurajuar vendin të vazhdojë me fokusin në procesin reformues, që sjellë rezultate për cilësinë e jetës së qytetarëve. Kryeministri Zaev theksoi se është në rrjedhë rrumbullakësimi i reformave të sigurisë, se deri në fund të shkurtit pritet në Parlament të votohen me konsensus ndryshimet e ligjeve që kanë të bëjnë me reformat në sistemin e jurisprudencës, se janë në rrjedhë reformat për profesionalizimin e administratës publike, si dhe për zgjedhje të anëtarëve të rinj, politik të Komisionit të antikorrupsionit.

"Anëtarësimi në NATO për shtetin tonë do të thotë paqe dhe kontribut i përhershëm i brendshëm drejt paqes në Ballkan, si dhe mundësi për zhvillim ekonomik, atë që qytetarët e presin me vite. Është shprehur interes nga disa investues të huaj për hyrje në vend, pas perspektivave të hapura atlantike. jemi inkurajuar nga përfaqësuesit e lartë të BE-së se nëse tregojmë implementim të reformave thelbësore, janë reale pritjet që vendi ynë në qershor të marrë datë për fillim të negociatave me BE-në. Ky është motivim edhe për institucionet, të tregojnë rezultate. Edhe përcaktimi im është, si Qeveri, të mbetemi të fokusuar drejt këtyre caqeve. Pres rezultate të shpejta, më të mëdha në planin ekonomik për qytetarët", tha kryeministri Zaev. Në takim u bë fjalë se Ballkani mbetet në fokus të Mbretërisë së Bashkuar dhe se suksesi diplomatik i Republikës së Maqedonisë është shembull për kontribut në stabilitetin dhe sigurinë, në rajon dhe në korniza më të gjera. Me atë rast, ishte shprehur pajtueshmëri e përbashkët se ekzistojnë mundësi të mëdha të hapura për thellim të bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar edhe në pjesën e tregtisë dhe ekonomisë, qëndron në kumtesë

Bombat e PSP-së, Jovevski pret Parlamentin

Shkup, 7 shkurt - Vetëm pas shprehjes së PSP-së me akt të posaçëm, Prokuroria Themelore mund të marrë përsipër lëndët e PSP-së, pas 30-të qershorit. Lëndët e PSP-së do të merren në bazë të parimit të legalitetit. Kështu ka thënë kryeprokurori Lubomir Jovevski, sipas të cilit, Prokuroria Publike nuk ka të drejtë të sugjerojë rreth vendimit që do të marrë PSP-ja lidhur me fatin e lëndëve të krijuara pas 30 qershorit. "Vendimi i Supremes bien ndesh me Ligjin e PSP-së lidhur me materialet dhe lëndët e ngritura nga PSP-ja. Vetëm Parlamenti mundet ta verifikojë qëllimin për të cilin është krijuar PSP-ja, edhe pse një mënyrë tjetër e zgjidhjes së situatës mund të jetë edhe miratimi i ligjeve për Prokurorinë Themelore, por deri në miratimin e tyre, vetëm interpretimi autentik do të zgjidhte ngërçin gjyqësorë mes Supremes dhe PSP-së", tha ai, ndërsa .Në ndërkohë, prokurori publik Bogdan Lazarevski ka thënë se Prokuroria Publike ka kapacitet të veprojë për të gjitha lëndët, edhe pse, siç është shprehur ai, nuk disponon me resurset të cilat i ka Prokuroria Publike Speciale në pjesën e gjendjes materialo-financiare dhe me kuadrin.

Gazetarët të punojnë pa pengesa

Bruksel, 7 shkurt - Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Maja Kocijaçiq, i përkujton të gjithë aktorët politik në Maqedoni se liria e mediave dhe gazetarëve ka rëndësi të posaçme për BE-në, njoftoi korrespondentja e MIA-s nga Brukseli.

Komisioni Evropian, përmes zëdhënëses Maja Kocijaçiq, reagoi në deklaratat e zëvendëskryeministrit Bujar Osmani dhe kumtesën e Ministrisë së Shëndetësisë. Në të dy rastet janë formuluar kërcënime për "pasoja juridike" ndaj mediave për mënyrën e informimit. Komisioni Evropian i cili rregullisht i ndjek ngjarjet në vend në prag të vendimit për fillimin e negociatave me Maqedoninë përkujton se BE-ja "i jep rëndësi të posaçme lirisë së mediave". "Raporti ynë në vitin 2018 theksoi se pse ka përmirësim në klimën mediatike, zero tolerancë duhet të ketë edhe për shqetësim fizik dhe verbal, si dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve", thotë për MIA-n Maja Kocijançiq.

Ajo shtoi se për Bashkimin Evropian është shumë me rëndësi që qytetarët të mund ta kryejnë detyrën në atmosferë e cila u mundëson të punojnë.

NË "MARIJA KIRI-SKLODOVSKA" BOJKOTOHET DREJTORI SHQIPTAR

RACIZËM I PROFESORËVE DHE NXËNËSVE MAQEDONAS

Racizmi maqedonas u tregua edhe në arsimin e mesëm. Nxënësit maqedonas, të nxitur nga profesorët e tyre, kanë nis bojkotin e procesit mësimor në shkollës e mesme kimike "Marija Sklodovska-Kiri" pasi nuk pranojnë drejtor shqiptarë. Kryetari i Shkupit, Petre Shilegov, bëri thirrje për normalizimin e marrëdhënieve dhe procesit arsimor, ndërsa ministri Ademi tha se tensionet dhe ndarjet ndëretnike në shkolla janë të papranueshme

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 7 shkurt - Racizëm i profesorëve dhe nxënësve maqedonas në shkollën e mesme kimike "Marija Kiri-Sklodovska". Pas emërimit nga Qyteti i Shkupit për ushtrues detyre drejtor të Blerim Nebiut, profesor i Psikologjisë po në këtë shkollë, ka shpërthyer shovinizmi maqedonas i profesorëve dhe nxënësve, duke bojkotuar mësimin dhe shprehur hapur kundër një drejtori shqiptarë.

I pari që kundërshtoi bojkotin është kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov, i cili tha se procesi arsimor nuk është rrënuar nga fakti se për ushtrues drejtues drejtori i shkollës së mesme kimike "Marija Kiri-Sklodovska" emëroi një shqiptar. Megjithatë, nxënësit të shoqëruar nga profesorët maqedonas, dje erdhën në shkollë, por bojkotuan procesin mësimor, ndërsa paralajmëruan se bojkoti do të vazhdojë edhe ditëve në vijim. Arsyetimi banal i maqedonasve, siç u tha dje në oborrin e shkollës, është se "vendimi i Qytetit të Shkupit është marrë pa dijeninë dhe konsultimin e tyre".

Për të qenë ironia më e madhe, profesorë maqedonas të kësaj shkollë janë shprehur hapur kundër një drejtori shqiptarë, madje edhe duke gënjyer. "Jemi kundër emërimit të drejtorit shqiptarë, sepse kemi pasur histori të hidhura në të kaluarën. Dikur kishim paralele të gjimnazit në maqedonisht dhe ku nxënësit maqedonas të Komunës Qendër vinin dhe u regjistronin këtu, por me hapjen e paraleleve edhe në shqip, askush nga maqedonasit nuk regjistrohen më dhe me këtë, janë mbyll paralelet në maqedonisht", thotë një profesoreshë maqedonase.

Thirrje që politika të qëndrojë jashtë shkollave ka bërë kryetari i Shkupit, ndërsa ka shtuar se u.d. drejtori Blerim Nebiu i plotëson kushtet për të drejtuar shkollën. "Dje, emërova ushtrues detyre drejtor që i plotëson të gjitha kërkesat ligjore, pavarësisht përkatësisë etnike. Unë nuk mendoj se ka vend për revoltë, as për ndonjë triumfalizëm. Politika nuk mund të hyjë në shkolla dhe nuk do ta lejoj këtë si kryetar komune", tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov, nën ingerencat e të cilit janë shkollat e mesme. Në përgjigje të pyetjeve të gazetarëve, Shilegov sqaroi se sipas Ligjit, kur duhet të merret vendimi për emërimin e një drejtori, këshillohet me Këshillin e shkollës, ndërsa kur emërohet ushtrues detyre drejtor, siç tha ai, Qyteti i Shkupit nuk e ka për obligim të konsultojë Këshillin e shkollës.

"Kjo nuk i jep të drejtë askujt, sidomos personelit mësimor të shprehë revoltën në këtë mënyrë. Bëj thirrje për normalizimin e marrëdhënieve dhe procesit arsimor, sepse nuk kemi nevojë të marrim masa dhe të krijojmë një situatë ku nuk ka hapësirë reale për asgjë shqetësuese", tha Shilegov. Bojkotin racist të profesorëve dhe nxënësve maqedonas e ka komentuar edhe ministri i Arsimit, Arbër Ademi. Në takim me gazetarët, Ademi dje tha se, megjithëse nuk është i njoftuar në detale, tensionet dhe ndarjet ndëretnike në shkolla janë të papranueshme.

"Duhet të jemi të interesuar për cilësinë e procesit arsimor. Nuk kemi nevojë për triumfalizëm, përveç përkushtimit për realizimin e një procesi edukimi cilësor. Nëse ka një hapësirë për çfarëdolloj përgjegjësie, unë do ta kërkoj. Por, meqë nuk jam i informuar në mënyrë të detajuar, ndoshta është i nevojshëm takim me profesorët dhe të gjitha palët e prekura në këtë rast", tha Ademi, duke shtuar se ai nuk ka marrë një kërkesë nga Këshilli i shkollës për takim në Qeveri apo në Qytetin e Shkupit.

Që nga viti 2009, kur edhe u formua paralelja e parë me mësim në gjuhën shqipe, në këtë shkollë të mesme vazhdimisht është rritur numri i nxënësve shqiptarë. Sot, kjo shkollë numëron 18 paralele me mësim në gjuhën shqipe në pesë drejtime, ndërsa 28 paralele janë në maqedonisht.

ARBËR ADEMI

Duhet të jemi të interesuar për cilësinë e procesit arsimor. Nuk kemi nevojë për triumfalizëm, përveç përkushtimit për realizimin e një procesi edukimi cilësor. Nëse ka një hapësirë për çfarëdolloj përgjegjësie, unë do ta kërkoj. Por, meqë nuk jam i informuar në mënyrë të detajuar, ndoshta është i nevojshëm takim me profesorët dhe të gjitha palët e prekura në këtë rast

PETRE SHILEGOV

Dje, emërova ushtrues detyre drejtor që i plotëson të gjitha kërkesat ligjore, pavarësisht përkatësisë etnike. Unë nuk mendoj se ka vend për revoltë, as për ndonjë triumfalizëm. Politika nuk mund të hyjë në shkolla dhe nuk do ta lejoj këtë si kryetar komune

RIKONSTRUIMI SQAROI SHUMË DILEMA

EKSPERTIZË E RE PËR "SAZDOVSKIN"

"Me këtë rikonstruim u vërtetuam të gjitha, duke përfshirë dështimatarët dhe të akuzuarit se i ndjeri Nikolla Sazdovski, jetën e ka humbur si pasojë se goditjes së kokës në kutinë EVN-së, që gjendet afër stacionit të autobusëve. Në këtë rast, po ashtu u vërtetua se nuk ka ekzistuar asnjë paramendim dhe aq më pak për vepër penale 'vrasje'. Pra, vdekja për fatë të keq, ka ndodhur si rezultat i veprës penale 'dhunë me pasoja vdekje'", tha avokati Raufi

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 7 shkurt - Ekipi i Institutit të Mjekësisë Ligjore pritet të realizojë ekspertizë të re për rastin e vdekjes së Nikolla Sazdovskit. Pala mbrojtëse e të akuzuarve Besir Bela e Skender Demiri, tha se Gjykata, pas përfundimit të rikontruimit të ngjarjes, ka vendosur që ekspertët e obduksionit, në bazë të deklaratave dhe përshkrimit të rastit nga vendngjarja, duhet të tregojnë nëse vdekje e Sazdovskit ka ndodhur si rezultat i goditjes në kutinë e EVN-së ose ajo ka ndodhur si pasojë i goditjeve nga të akuzuarit. Sipas avokatit Naser Raufi, rikonstruimi i kësaj ngjarje ka kontribuar mjaftueshëm që të vërtetohet gjendja faktike e rastit.

Ndërkohë, qëndrimi i palës së dëmtuar, respektivisht sipas avokatit Vanço Shehtanski, me këtë rikonstruim u pastruan shumë dilema, mes tjerash edhe fakti se nuk bëhet fjalë për kuti të metalit, por se për një kuti të plastifikuar.

"Me këtë rikonstruim u vërtetuam të gjitha, duke përfshirë dështimatarët dhe të akuzuarit se i ndjeri Nikolla Sazdovski, jetën e ka humbur si pasojë se goditjes së kokës në kutinë EVN-së, që gjendet afër stacionit të autobusëve. Në këtë rast, po ashtu u vërtetua se nuk ka ekzistuar asnjë paramendim dhe aq më pak për vepër penale 'vrasje'. Pra, vdekja për fatë të keq, ka ndodhur si rezultat i veprës penale 'dhunë me pasoja vdekje'", tha avokati Raufi.

Ndërkohë, qëndrimi i palës së dëmtuar, respektivisht sipas avokatit Vanço Shehtanski, me këtë rikonsturium u pastruan shumë dilema, mes tjerash edhe fakti se nuk bëhet fjalë për kuti të metalit, por se për një kuti të plastifikuar.

"Ne nuk ishim kundër rikonstruimit, përkundrazi - edhe ne insistonim që të sqarohen dilemat, me çka përrallat e palës mbrojtëse se ekziston kutia fantome e metaltë sot u demantua. Fillimisht u pa se nuk ka kuti metali, por se bëhet fjalë për kuti të plastifikuar, e cila nuk mund të shkaktojë asnjë lloj pasoje. Por edhe rrëfimet e dështimatarëve dhe personave ekspertë e dëshmuan se vdekja ka ndodhur si pasojë e goditjeve që kanë ndodhur deri në 1 minutë e gjysmë", tha Shehtanski.

Meqë familja e të ndjerit Nikolla Sazdovski, përmes avokatit të tyre e ka kontestuar faktin se bëhet fjalë për kuti të metal, avokatët e të akuzuarve Bela e Demirit paralajmëruan se në seancën e radhës, në Gjykatë do të propozojnë të ftohet një përfaqësues i EVN-së, për ti vërtetuar qëndrimet e tyre.

Ndryshe, procesi gjyqësor kundër të akuzuarve për vdekjen e Sazdovskit, deri më tani është zhvilluar nën kritikat e ashpra të publikut dhe opinionit të ekspertëve. Rikualifikimi i rastit, gjegjësisht akuzat e Prokurorisë së Shkupit se Besir Bela, Skender Demiri dhe Jeton Luzha kanë kryer "vrasje mizore" ndaj Sazdovski, për pjesën dërmuese të opinionit janë të papranuara. Seanca e radhës për këtë ngjarje është caktuar të mbahet me datë 28 shkurt.

Edhe një viktimë e gripit

Shkup, 7 shkurt - Është regjistruar viktima e dytë nga gripi sezonal. Pas pesëvjeçares nga Shutka e Shkupit, rasti i dytë është regjistruar në Ohër ku ka ndërruar jetë një 24-vjeçare, cila ka qenë e shtrirë në Klinikën për anestezion, kujdes intensiv dhe reanimacion në Shkup. Ajo kishte ndërruar jetën para dy ditësh, por rasti është publikuar dje nga autoritetet shëndetësore. "Në të dy rastet pacientët përveç gripit kanë pasur edhe simptome të sëmundjeve tjera. Te njëra konstatuam astmë, ndërsa të tjetra ka qenë sindromin dowm kështu që të dy rastet kanë ndërruar jetë pasi kanë pasur ndezje të rëndë të mushkërive të bardha, dhe dëmtim të rëndë të mushkërive të zeza", tha Zharko Karaxhovski nga Instituti i Shëndetit Publik. Gjatë javës së kaluar janë regjistruar 1752 raste me grip që është dyfishi i numrit të regjistruar një javë më parë. Epidemiologët lëshojnë alarmin se numër edhe më i lartë i të prekurve nga gripi pritet periudhën që vijon. 85% e të gjitha rasteve të izoluara në këtë moment janë të tipit H1N1 e cila në opinion njihet si gripi i derrave. Rastet tjera janë H3N1 dhe kemi dy raste të pa përcaktuara.

Mijallkovi nuk lirohet nga ndjekja te "Tortura"

Shkup, 7 shkurt - Gjykata në seancën e djeshme për lëndën "Tortura" e ka refuzuar kërkesën e ish-shefit të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, Sasho Mijalkov që të lirohet nga ndjekja për arrestimin e Lube Boshkoskit në vitin 2011. Në fillim të seancës, mbrojtësit e Mijalkovit kërkuan nga gjykata që ta hedhë poshtë aktakuzën për lëndën "Tortura" dhe t'i lirojë nga përgjegjësia penale të akuzuarit në këtë lëndë.

Sipas avokatëve, aktakuza për këtë lëndë është parashtruar rreth 20 ditë pas skadimit të afatit prej 18 muajve, në të cilat PSP ka mundur të parashtrojë. PSP iu kundërshtua kërkesës së tillë, duke theksuar se gjykata pozitivisht ka vendosur për akuzën, që do të thotë se gjykata e ka pranuar PSP-në si paditës të autorizuar. Gjykatësja Aleksandra Ristevska e refuzoi propozimin dhe seanca vazhdoi me marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

Në lëndën "Tortura" së bashku me Sasho Mijalkovin, janë akuzuar edhe ish njeriu i parë i njësisë "Alfat", Ivica Antevski-Puki, dhe katër pjesëtarë të njësisë.

KRONIKË

Arrestohet 59 vjeçari, kërkohej për grabitje

Pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë dje rreth orës 12 e 40 minuta, kanë privuar nga liria 59 vjeçarin A.M. nga fshati Koritë, për të cilin gjykata ka shqiptuar tre vite dënim me burg për vepër penale "grabitje". Pas arrestimit të realizuar me urdhër të gjykatësit, A.M. është dorëzuar në burgun e Tetovës për vuajtjen e dënimit.

Arrestohet i arratisuri nga burgu

Të mërkurën mbrëma rreth orës 20 e 40 minuta, në fshatin Bogovinë të Tetovës është privuar nga liria 25 vjeçari N.I. nga po i njëjti fshat, i cili me urdhër të burgut të "Idrizovës", ka qenë në kërkim për vazhdimin e vuajtjes së dënimit me burg, pasi pas shfrytëzimit të vikendit të lirë, nuk është kthyer në burg.

Vozitja e shpejtë fatale për vozitësit

Policia e Tetovës njofton se gjatë janarit të këtij viti, shkaku më i shpeshtë i aksidenteve në trafikun rrugorë në rajonin e Tetovës është shpejtësia e papërshtatshme sipas kushteve në rrugë. Nga gjithsej 63 aksidente të evidentuara gjatë këtij muaji, gati një e treta e tyre, gjegjësisht 22 aksidente kanë ndodhur si pasojë e vozitjes së shpejtë, ndërsa 9 aksidente kanë ndodhur për shkak të veprimeve të pa rregullta në rrugë. 42 nga aksidentet e muajit të kaluar kanë ndodhur nëpër vendbanime edhe atë nëpër rrugët e qytetit të Tetovës 29 aksidente, si dhe në rrugën regjionale Tetovë-Jazhincë 16 aksidente dhe në autostradën Gostivar-Tetovë-Shkup 14 aksidente. Gjatë muajit janar gjithashtu janë regjistruar edhe 6 devijime nga rruga, kurse 8 aksidente kanë qenë të shkaktuara nga kafshët, gjegjësisht qen të pa strehë, të cilët kanë lëvizur nëpër autostradë. Në këto aksidente, numri më i madh i të lënduarve - edhe atë 30 kanë qenë bashkudhëtarë ose pasagjerë. 37 nga aksidentet e ndodhura kanë përfunduar vetëm me dëme materiale, 1 aksident me pasoja tragjike ku një person humbi jetën, në 4 aksidente 4 persona kanë marrë lëndime të rënda trupore, kurse në 21aksidente - 47persona kanë marrë lëndime të lehta trupore

16 vjeçarja shantazhohet nga një tetovar

Një 16 vjeçare, banore e fshatit Xhepçisht, në prani të prindit të saj, të mërkurën ka denoncuar "shantazh" që e ka kryer një 17 vjeçar nga lagjja e Drenovecit, me të cilin në shtator të vitit të kaluar, janë njoftuar nëpërmjet rrjeteve sociale. Duke iu kërcënuar, 17vjeçari prej saj ka kërkuar dhe ka marrë stoli të llojllojshme prej ari. Minoreni i denoncuar, menjëherë është thirrur në Stacionin policorë në Tetovë dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit. *(U.H)*

Subvencione për eko-pajisje bashkëkohore për ngrohje

Shkup, 7 shkurt - Qyteti i Shkupit për herë të parë deri më tani shpallë konkurs publik për subvencionim të pajisjes klimatike inverter dhe pajisjeve të tjera bashkëkohore për ngrohje të amvisërive.

"Për çdo pajisje klimatike inverter, çdo qytetar i interesuar i cili do t'i plotësojë kushtet për subvencionim do të ketë mundësi të marrë gjysmën nga vlera e përgjithshme e pajisjes, por jo më shumë se 15.000 denarë", tha në konferencën e sotme për shtyp kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov. Për këtë dedikim në buxhetin e qytetit, siç tha, parashikuam 20 milionë denarë, ndërsa kjo do të thotë se mbi 1.300 amvisëri prej këtij viti do të kenë mundësi që më lirë t'i ngrohin shtëpitë e tyre, duke mbajtur llogari për uljen e ndotjes së ajrit. Përparësia e pajisjes klimatike inverter është në atë që shpenzojnë rreth 30 për qind më pak energji elektrike se pajisja e zakonshme klimatike, ndërkaq mbi 50 për qind i ulin edhe shpenzimet në krahasim me drurin për ngrohje.

Sipas analizave të Qytetit të Shkupit, interesi tek qytetarët për furnizim të pajisjeve më bashkëkohore për ngrohje është i madh dhe për këtë shkak ata kanë vendosur për subvencionim të këtyre pajisjeve dhe për t'i ulur shpenzimet e qytetarëve. Konkursi për subvencionim, siç paralajmëroi kryetari i Qytetit, do të shpallet më së voni deri të hënën.

NIS LUFTA TREGTARE

GREKËT TË BRENGOSUR PËR BRENDIN "MAQEDONIA"

"Nga ajo se si qëndrojnë gjërat, marrëveshja nuk shton vlerën, por zbret, sepse ne ndajmë emrin e markës Maqedoni. Duke parë shkronjën 'N' (kjo do të thotë termi 'veri'), nuk do të bëjmë dallim të rëndësishëm të konsumatorëve evropian", thotë Vasilis Korkidis nga Oda Ekonomike së Pireut, duke shtuar se marrëveshja mund tu japë bizneseve mundësinë për të pasur markën e tyre

Shkup, 7 shkurt - Brendi "Maqedoni" shfaqet në 182 biznese greke, ndërsa mbi katër mijë kompani greke e përdorin atë në përshkrimin e të paktën një produkti, duke e bërë të paqartë se si do të vazhdojnë ta përdorin atë pas ratifikimi të Marrëveshjes së Prespës, shkruan gazeta "Kathimerini", botimi në anglisht. Oda Ekonomike në Greqinë e Veriut tashmë ka ofruar asistencë ligjore për bizneset që kërkojnë sqarime të mëtejshme të detajeve të marrëveshjes.

Marrëveshja siguron të drejtat që kompanitë greke kanë sipas rregulloreve të BE-së. Paragrafi tre i nenit të parë thotë se dy palët bien dakord të mbështesin komunitetin e tyre të biznesit në zbatimin e një dialogu të mirë të strukturuar në mënyrë që të gjejnë zgjidhje të pranueshme reciprokisht për çështjet që dalin nga emrat tregtar dhe markat tregtare, si dhe nga të gjitha çështjet e rëndësishme në nivel bilateral dhe ndërkombëtarë. Një ekip ekspertësh nga të dy vendet do të formohet për tu përqendruar në çështjet mbi emrat dhe tiparet mbrojtëse (do të funksionojë deri në vitin 2022), e cila duhet të zgjidhet sipas Marrëveshjes së Prespës.

"Nga ajo se si qëndrojnë gjërat, marrëveshja nuk shton vlerën, por zbret, sepse ne ndajmë emrin e markës Maqedoni. Duke parë shkronjën 'N' (kjo do të thotë termi 'veri'), nuk do të bëjmë dallim të rëndësishëm të konsumatorëve evropian", thotë Vasilis Korkidis nga Oda Ekonomike së Pireut, duke shtuar se marrëveshja mund tu japë bizneseve mundësinë për të pasur markën e tyre. Ai vlerëson se rreth 400 kompani greke në Shkup përfaqësojnë investime me vlerë më shumë se 1.7 miliard dollarë. Korkidis shprehu shqetësimin se vetëm 24 kompani greke kanë mbrojtur produktet me termin "Maqedonia në BE", ndërsa vetëm dy kanë produkte të mbrojtura në nivel ndërkombëtarë.

Dinamika ekonomike sugjeron se një zgjidhje e shpejtë është në interes të përbashkët. Thuhet se Maqedonia ka marrëdhënie të forta tregtare me Greqinë nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, që është investitori më i madh në Maqedoni që nga fundi i viteve 1990, sipas Al Jazeera, i cili njofton se Greqia ka investuar më shumë se 500 milion dollarë në Maqedoni në vitin 2017. *(Q.A)*

Hiqet gardhi i hekurt rreth Qeverisë

Shkup, 7 shkurt - Para Qeverisë filloi heqja e gardhit me kangjella të hekurta. Vendimi për heqjen e kangjellave e mori Qeveria në seancën e fundit të mbajtur pardje, ndërsa qëllimi, siç nënvizuan, është që të lirohet hapësira publike rreth ndërtesës së qeverisë dhe të mund të përdoret nga ana e qytetarëve. Për heqjen e gardhit me kangjella sipas zëdhënësit qeveritar Mile Boshnjakovski nuk do të shpenzohen para nga qytetarët, por do të përdoren resurse të brendshme, respektivisht kapacitetet ekzistuese të shërbimeve në kuadër të Qeverisë. Kangjellat do të vendosen në magazinë, ndërsa vendimet e mëtejshme lidhur me kangjellat dhe hapësirën rreth ndërtesës së Qeverisë, do të sillen përmes procesit inkluziv në konsultim me qytetarët. Kolonat e betonit momentalisht nuk do të hiqen sepse siç sqaroi Boshnjakovski, heqja e tyre kushton shumë, ndërsa Qeveria nuk ka për qëllim që të shpenzojë mjete shtesë që t'i korrigjojë gabimet e pushtetit të kaluar.

Gjinekologjia e Çairit vazhdon të ndot ajrin

Shkup, 7 shkurt - Qyteti i Shkupit deri më tani nuk ka marrë dëshmi se ka filluar ndonjë procedurë në Spitalin Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë "Nënë Tereza" në Çair, pas shkrimeve se nga spitali del tym dhe ndot tej mase. Spitalit i është dhënë afat prej 30 ditëve që ta zgjidhin problemin me kazanin.

Kryetari i Shkupit, Petre Shilegov, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve, tha se pret që spitali të fillojë procedurë në afatin e dhënë prej 30 ditëve. "Pas fillimit të procedurës, nëse njihemi me gjendjen e përcaktuar faktike, atëherë mund të mendojmë për rishqyrtim të vendimit. Por, nuk mund të tolerojmë mosfunksionimin e institucioneve të cilat në fund të ditës shkojnë në dëm të të gjithë qytetarëve", tha Shilegov. Ai sqaroi se sipas Ligjit, nuk ka paralajmërim, por ata kanë lëshuar njoftim me shkrim. Jashtë kësaj njoftim me shkrim, siç tha, spitali mund të marrë gjobë dhe mbylljen e kazanit.

I pyetur deri ku është procedura për projektimin e bulevardit nga Aerodromi në drejtim të Keramindnicës, Shilegov tha se projektimi ka përfunduar, ndërsa fazën e parë e vendosin në përpunim. Hapja e ofertave për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm të aktiviteteve ndërtimore është caktuar për më 14 shkurt të këtij viti. Për kryetarin e Shkupit është me rëndësi që në pranverë do të fillojnë me aktivitetet ndërtimore të realizimit të korridorit të ri në qytetin tonë. *(Q.A)*

LEGALIZIMI I SHTËPIVE EC NGADALË

GJYSMA PA TAPI

Në gati tetë vitet e kaluara, mbi 210 mijë ndërtime pa leje kanë zgjidhur statusin e tyre dhe kanë fituar fletëpronësi, ndërsa mbi 440 mijë kërkesa janë parashtruar për legalizimin e trojeve

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 7 shkurt - Më 31 dhjetor të viti 2018 skadoi afati për dorëzimin e kërkesave të reja për legalizimin e patundshmërive , si dhe afati për dorëzimin e dokumenteve që mungojnë, ku dominonte elaborate gjeodezik. Me fjalë të tjera pasi shteti, tre herë prej muajit mars të vitit 2011 deri më fundin e vitit të kaluar ju mundësoi qytetarëve të legalizojnë pronat e tyre, konform Ligjit për veprimin me objektet e ndërtuara pa leje, akoma një pjesë e madhe e kërkesave të qytetarëve kanë mbetur të pazgjidhura dhe qëndrojnë në sirtarët e komunave si rrjedhojë e problemeve të ndryshme administrative.

PROBLEMI I PRONËS SHKAKTON VONESA

Në gati tetë vitet e kaluara , mbi 210 mijë ndërtime pa leje kanë zgjidhur statusin e tyre dhe kanë fituar fletë pronësi , ndërsa mbi 440 mijë kërkesa janë parashtruar për legalizimin e trojeve. Nga ana tjetër, autoritetet kanë deklaruar se nuk do të ketë zgjatje të re të afateve për legalizim. Njëherazi, praktika tregon se nëpër komuna, pengesa kryesore që pengon zgjidhjen e kërkesave të parashtruara për legalizim janë çështjet e pazgjidhura pronësore-juridike. Në teren , ekzistojnë problem të ndryshme që ndërlidhen me kërkesat për legalizim që janë në fazë të zgjidhjes me deklaratë të vërtetuar në noter se objekti është ndërtuar para se të hyjë në fuqi Ligji për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje. Problemet e tjera kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë nga më shumë pronarë, që shpesh pengon procesin e legalizimit. Nga Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale thonë se me vendim të Këshillit drejtues, është kërkuar nga Ministria e Transportit që të krijohet një trup që do të përgatisë zgjidhje ligjore për tejkalimin e problemeve.

"Do të formohet grup pune i cili në aspekt teknik do të përcaktojë zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen komunat gjatë veprimit me këto lëndë", thotë Dushiça Perishiq, drejtoreshë e BJNVL-së. Edhe nga organizata që përfaqëson dhe mbron interesat e të gjithë 85 komunave në Maqedoni së bashku me qytetin e Shkupit, por edhe nga Ministria e Transportit , thonë se nuk ka nevojë për zgjatje të reja të afateve që do mundësonin parashtrimet eventuale të kërkesave të reja, por shtojnë se nevojitet të krijohet një ambient më i favorshëm që do të mundësojë zgjidhjen më të lehtë dhe më të shpejtë të lëndëve të shumta të legalizimit të trojeve.

Analizat tregojnë se para katër vitesh, problemi kryesor të cilin e vërejtën institucionet ishte mos kompletimi i dokumentacionit për legalizim me elaboratet e nevojshme gjeodezike. Kjo dëshmohet edhe me faktin se deri në fillim të vitit 2015, mbi 150 mijë qytetarë që kanë parashtruar kërkesë nuk kanë dorëzuar elaborat, andaj Kadastra nuk mund të lëshonte fletë-posedimin .Në vitet e kaluara, kryetarët e komunave pohonin se vonesat e legalizimit të pronave ishin të natyrave të ndryshme. Shkaqet e ngecjes, krahas vonesave në dorëzimin e elaborateve ishin edhe neglizhenca, mungesa e të hollave, por edhe pengesat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore që pritej të tejkalohen me ndryshimin e dispozitave ligjore përkatëse.

Në dy afatet e fundit për legalizim u kërkua fletë pronësia për mbi 440 mijë objekte të ndërtuara pa leje, ndërsa akoma nuk ka të dhëna lidhur me shifrën përfundimtare për të cilën kërkohet legalizim i pronave deri më fundin e vitit 2018.

NDËRTIMET PA LEJE NË RAJON

Ndryshe , ndërtimet pa leje në rajon kanë qenë fenomen i vazhdueshme, ndërsa gati të gjitha vendet e rajonit kanë pasur më shumë ndërtime pa leje. Problemi i legalizimit të patundshmërive të ndërtuara pa dokumentacionin e pronësisë mundon tërë Ballkanin. Deri në muajin shkurt të vitit 2015, llogariteshin n mbi 1 milion ndërtime pa leje në të katër shtetet e Ballkanit; Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal i Zi. Shifra është bërë publike në Tiranë në konferençën përmbyllëse rajonale "Informaliteti, zgjidhje dhe sfida", ku përfaqësues nga të katër vendet kanë diskutuar dhe ndarë mes tyre përvojat dhe eksperiencat më të mira në menaxhimin e procesit të legalizimeve. Problemi më i madh dhe i përbashkët i këtyre vendeve, mbetet shifra e lartë e ndërtimeve pa leje, por edhe pronësia e këtyre objekteve.

Qeveria shqiptare në muajin nëntor të vitit 2018, ndryshoi procedurën dhe kriteret për legalizimin e 77 mijë ndërtimeve pa leje që deri më tani kanë mbetur pa u ligjëruar. Nëpërmjet projektligjit për "Përfundimin e proceseve kalimtare të kalimit të pronësisë", ekzekutivi i jep dhe një mundësi tjetër të gjithëve atyre që për shkaqe apo arsye të ndryshme nuk kanë mundur ta legalizojnë banesat apo ndërtimet e ndërtuara pa leje, në tokë të një tjetri apo edhe në tokën e tyre. Në Shqipëri, pothuajse gjysma e ndërtimeve pa leje janë legalizuar, por çfarë mbetet përbën edhe pjesën më të vështirë të një procesi 13-vjeçar, të nisur, por ende të pazgjidhur . Formalizimi i zonave informale mund të konsiderohet një kapitull i mbyllur, por sprova e vërtetë duket se është kjo që sapo ka filluar. Legalizimi i objekteve në brendësi të zonave urbane nuk mund të zgjidhet sa hap e mbyll sytë. Deri në vitin 2017, nga të dhënat zyrtare rezulton se në periudhën 2014 -2017, janë legalizuar rreth 144 mijë objekte. Kjo do të thotë se janë edhe 179 mijë objekte të tjera, të cilat i nënshtrohen procedurave të pajisjes me tapi. Në Kosovë, legalizimi i ndërtimeve pa leje në territorin e Kosovës pritet të zgjasë edhe disa vite. Në Kosovë, mbi 352 mijë ndërtime pa leje janë të evidentuara në Ministrinë e Mjedisit, Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Në Kroaci vetëm deri në fund të vitit 2013 janë dorëzuar mbi 830 mijë kërkesa për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, ndërsa mbi 600 mijë edhe janë legalizuar. Megjithatë ky proces po zgjat edhe më tej pas zgjatjes së afatit deri në 30 qershor të vitit 2018. Në Mal të zi sipas autoriteteve të kadastrës janë shënuar mbi 40 mijë objekte jo legale, ndërsa analizat e Ministrisë së zhvillimit të qëndrueshëm tregojnë se mbi 100 mijë objekte janë të ndërtuara pa leje. Në Serbi, mbi 1.5 milion qytetarë kanë ndërtuar shtëpitë e tyre pa leje.

BASHKËSIA E BIZNESIT ME PROPOZIME PËR ULJEN E NDOTJES SË AJRIT

BALLAFAQIM URGJENT ME DEPOZITË E EGRA

Shkup, 7 shkurt - Aksion i përbashkët i sektorit privat dhe publik për zëvendësim më të shpejtë të automjeteve të vjetra ne automjete të reja elektronike, ballafaqim urgjent me deponitë e kundërligjshme dhe promovimin e standardit për shtëpi pasive, te të cilët energjia konsumatore për ngrohje ulet për 90 për qind, janë tre propozimet e Lidhës së Odave Ekonomike të Maqedonisë në drejtim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit.

Për dallim nga shtetet evropiane ku shënohet rritje e shitjes së automjeteve elektronike në Maqedoni nga fillimi i vitit 2018 deri në tetor janë blerë vetëm 48 automjete elektronike që është numër shumë i vogël. "Përftimi nuk është vetëm në uljen e ndotjes së ajrit, por ka kursim serioz edhe në konsumin e karburanteve. Nga përvoja personale, kursimi i konsumit të karburanteve është rreth 80 deri 90 për qind që janë para reale të cilat nuk i japim për karburante. Automjetet nuk janë shumë të shtrenjta dhe çmimi i një automjeti të tillë do të ishte i përafërt me çmimin e një automjeti disel me performansa të njëjta. Do të thotë nuk duhen, shumë para të investohen, ndërsa kemi kursim, përfitime dhe kemi përgjegjësi shoqërore", theksoi sot në konferencë për media Aleksandar Milloshevski", zëvendëskryetar i LOE.

Arsye për shitjen dhe përdorimin e vogël të këtij lloji të automjeteve, sipas LOE, janë çmimet e këtyre automobilave, por edhe infrastruktura e pazhvilluar dhe mbushësit e instaluar. Krahas subvencionimit që Qeveria e paralajmëroi për blerjen e automjeteve të tilla, nga LOE propozojnë të subvencionohet dhe blerje e baterive dhe pjesëve për këto automjete, si dhe të shqyrtohet mundësia për pikëpagesa dhe parkingje falas dhe lirim nga pagesat doganore gjatë importit të automobilave të tillë. Lidhur me deponitë e kundërligjshme, LOE propozon të shfrytëzohen teknologji të reja të llojit drone dhe të incizohet terreni për zbulim më të lehtë dhe trajtimin e këtij problemi.

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

Në bisedë u theksua se Serbia është e përkushtuar për zbatimin e reformave të nevojshme në rrugën evropiane, thuhet në komunikatë.

Plaçkitjet e bankave trembin investitorët e huaj në Kosovë

Oda Tregtare Kosovaro Turke (OTKT) përmes një reagimi ka shprehur shqetësimet pas shpeshtimit të plaçkitjeve bankave. "Në sytë e investitorëve të huaj, këto plaçkitje po japin një bindje të paqëndrueshmërisë së rendit dhe sigurisë publike të vendit tonë, që do të thotë se dëmi më i madh po u shkaktohet shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të saj", thekson reagimi.

Sektori bankar në Kosovë është një nga sektorët kryesorë me rol shumë të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë së vendit, si dhe për stabilitetin ekonomik dhe atë social të tij. Një sistem bankar i qëndrueshëm dhe i fuqishëm konsiderohet parakusht për rritjen e investimeve në vend si dhe për tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Marrë parasysh rëndësinë e tij për ekonominë, jemi me fat që në Kosovë kemi një sistem shumë të fuqishëm dhe stabil bankar. Por, për fat të keq, plaçkitjet e vazhdueshme të bankave, të cilat kohët e fundit janë bërë kërcënim për tërë sektorin dhe shoqërinë, kanë arritur përmasa alarmuese. Shqetësimi i sektorit bankar nuk përbën vetëm goditje kundër zhvillimit ekonomik të vendit, por dëmtim të perceptimit të qytetarëve ndaj këtij sistemi dhe grusht kundër të ardhmes së Kosovës. Grabitjet dhe vjedhjet jo vetëm që po krijojnë një mjedis të pasigurt në sytë e qytetarëve, por edhe po ngrehin shqetësime rreth përdorimit të burimeve financiare të zhvatura në organizatat kriminale dhe aktivitetet e paligjshme. Nga ana tjetër, në sytë e investitorëve të huaj, këto plaçkitje po japin një bindje të paqëndrueshmërisë së rendit dhe sigurisë publike të vendit tonë, që do të thotë se dëmi më i madh po u shkaktohet shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Me këtë rast ne u bëjmë thirrje autoriteteve dhe politikanëve të vendit që të trajtojnë këtë çështje me ndjeshmëri dhe seriozitet, ndërsa ftojmë autoritetet publike dhe zbatuesit e ligjit që të marrin masa më të rrepta për të garantuar siguri më të madhe dhe stabilitet në vend, thuhet në fund të reagimit të OTKT-së.

Gruaja e zëdhënësit të presidentit Vladimir Putinit, Dimitri Peskov, ka një perandori me prona që kap vlerën mbi 10 milionë dollarë dhe po projekton një pallat buz lumit një zonë ekskluzive në Moskë, që Guardian do të zbulojë. Projekti është duke u mbikëqyrur nga një manjat rus, që më parë ka bërë biznes me Donald Trump, tregojnë dokumentet

NJERËZIT E PUTINIT TË MBULUAR ME LUKS

Dhënia e informacioneve shpjeguese ka të ngjarë të ngrejë pyetje të reja rreth pasurisë së Peskov dhe se si ai dhe bashkëshortja e tij, Tatiana Navka, duket se janë në gjendje të përballojnë një mënyrë jetese tepër të pasur.

Udhëheqësit rusë të opozitës kanë kritikuar në mënyrë të përsëritur mënyrën e jetesës së Peskov që nga dasma e tij e famshme në vitin 2015 me Navka, një balerine e patinazhit në akull dhe kampione, e cila fitoi medaljen e artë për Rusinë në Lojërat Olimpike të 2006.

Megjithëse e pasur në të drejtën e saj, një investigim i udhëhequr nga Dossier Center, së bashku me Guardian, sugjeron se pasuritë dhe shpenzimet e çiftit janë më të mëdha se sa është raportuar. Në tetor 2014, Navka bleu një pronë të nivelit më të lartë në Rublikovë, zona e pyllëzuar në perëndim të Moskës, që është shtëpia e Putinit, presidentit të Rusisë dhe shumë prej elitës sunduese të vendit. Shtëpia në fshatin Tretya O khota në dhjetor 2012 u ofrua për shitje me një çmim 15.6 milion dollarë.

Por sipas dokumenteve të para nga Guardian, Navka e bleu në tetor 2014 për 300 milion rubla (7.1 milion dollarë), një zbritje prej 8.5 milion dollarë. Çmimi përfshinte dy pjesë të tokës që kushtonin 3.5 milion dollarë. Navka e mobiloi shtëpinë duke u konsultuar me burrin e saj për çdo gjë, nga pajisjet e palestrës, saunen dhe artikujt e porositur nga një boutique në Qipro, që kushtonin më shumë se 500,000 euro.

Shitësi i pronës është Timur Khaldarov, një figurë pak e njohur, i cili drejtoi një fondacion bamirës sportesh dhe artesh, sipas mediave ruse . Themeluesi i fondacionit është Alisher Usmanov, një nga oligarkët më të fuqishëm dhe me ndikim politik të Rusisë. Usmanovi ishte së fundi një aksionar i madh në klubin e futbollit të Arsenalit dhe në 2018 njeriu i tetë më i pasur i Britanisë së Madhe. Sipas Dosjes, Peskov dhe Navka bënë plane për një rezidencë edhe më të madhe, në një kompleks ekskluziv në rajonin e Moskës, qe i përkisten manjatit Aras Agalarov . Në mars 2018, Agalarov personalisht miratoi propozimin e ndërtimit, në një vend të quajtur Rechnaya # 27, tregojnë dokumentet.Kompleksi ndodhet brenda një zone të pasur për rusët, me një fushë golfi dhe plazh privat.

Dokumentet tregojnë në 2017 se çifti punësoi një firmë të arkitektëve amerikanë, Zampolin & Associates , me seli në Westwood të New Jersey, për të hartuar një mini-pallat të ri të njohur si vendbanimi i Yanavka. Themeluesi i firmës, Bob Zampolin, fluturoi në Moskë për të diskutuar detajet me Navka. Propozimi i tij përmban 2.400 metra hapësirë të gjelbër, një hyrje të veçantë për stafin, një pishinë, spa, sauna dhe bibliotekë. Projekti ishte aktiv në mesin e vitit 2018. Statusi i tij aktual është i paqartë.

Javën e kaluar, nuk kishte asnjë shenjë të ndërtimit të punës. I pyetur nëse plani ishte duke shkuar përpara, Navka u përgjigj: "Kjo nuk ka lidhje me ju."

Ajo tha se marrëdhënia e saj me Zampolin ishte personale dhe "nuk ishte e lidhur me planet për të blerë prona kudo". Fotoja e fundit e Navka për një revistë ruse u be në hotelin Agalarov Estate. Zbulimet mund të provokojnë pyetje të reja rreth pasurisë së Peskov dhe çdo përfitim të mundshëm që ai dhe gruaja e tij kanë fituar nga marrëdhënia e tij e ngushtë me Putin. Këto publikime do të nxisin pyetje për financat e Navka-s.

Pas 2014, Navka hapi tre llogari bankare zvicerane, tregojnë dokumentet. Llogaritë ishin me degën e Cyrihut të Bankës Ndërkombëtare të Luksemburgut, në dollarë, euro dhe rubla. Ajo gjithashtu ngriti një kompani në Ishujt e Virgin, një vend për fshehjen e taksave. Kompania Carina Global Assets, u zbulua në Panama, sipas gazetave. Në atë kohë Navka mohoi të ketë ndonjë kompani apo llogari në këto parajsa fiskale. Navka gjithashtu ka te tjera pasuri, duke përfshirë një banesë elite në rrethin qendror Yakimanka të Moskës, me vlerë 4 milion dollarë, dhe i është dhënë asaj nga shteti si shpërblim për suksesin e saj sportiv. Ajo gjithashtu ka një banesë 2 milion dollarë në periferi të Poljanka në Moskë. Çifti ka fëmijë nga lidhjet e mëparshme dhe një vajzë e lindur në gusht 2014. Peskov ka qenë i besuari Putin për 20 vjet dhe konsiderohet si një nga njerëzit më të fuqishëm në Rusi. Ai ishte i përfshirë në diskutime mbi një marrëveshje pronësie në Moskë, mbajtur me ish-avokatin e Trump, Michael Cohen, i cili ka pranuar se ai gënjeu për planet për të ndërtuar një Kullë Trump në Moskë. Cohen i dërgoi email Peskov duke kërkuar ndihmë dhe mbajti një telefonatë 20 minutëshe me një nga asistentët e tij. Peskov më vonë e ftoi Cohen në forumin ekonomik të St Petersburgit dhe i ofroi lehtësime në takime të nivelit të lartë me Putinin dhe Medvedevin. Peskov dhe Agalarov shfaqen në dosjen e përpiluar nga ish zyrtari i MI6 Christopher Steele.

}Ai pretendon se Kremlini mban materiale kompromietuese për Trump, disa prej të cilave thuhet se janë mbledhur gjatë vizitës së Trump në Moskë në vitin 2013 për garën e Miss Universe. Dosja thotë se Peskov ishte përgjegjës për mbështetjen e Trump ndaj Hillary Clinton, si pjesë e përpjekjes më të gjerë të Moskës për të ndikuar në zgjedhjet presidenciale të 2016 në favor të Trump.

Këshilltari i posaçëm Robert Mueller po shqyrton marrëveshjen e dyshuar midis fushatës së Trump dhe Rusisë. *(TemA TV)*

Ukraina ndryshon Kushtetutën për integrim në BE dhe NATO

Parlamenti i Ukrainës ka miratuar të enjten një projektligj mbi ndryshimet në Kushtetutë për çështjen e Politikës së Jashtme të Ukrainës.
Ky projektligj nga Parlamenti i Ukrainës vjen si vendim për anëtarësimin në BE dhe NATO.
334 deputetë votuan "për" dokumentin.
Amandamentet do të hyjnë në fuqi pasi zëdhënësi i parlamentit dhe presidenti nënshkruajnë dokumentin

SHBA do të jetë e angazhuar në luftën kundër ISIS

Sekretari i Shtetit të SHBA-së, Mike Pompeo ka siguruar partnerët e koalicionit se tërheqja e trupave të tyre nga Siria nuk nënkupton "fundin e luftës së Amerikës".

Ai ka ftuar ata që të japin ndihmën e tyre të përhershme deri në mposhtjen e Shtetit Islamik – ISIS, shkruan AlJazeera.

"Tërheqja e trupave s'është fundi i luftës së Amerikës. Këtë luftë do ta vazhdojmë krah jush", ka thënë Pompeo gjatë adresimit para ministrave të jashtëm të 79 shteteve që punuan bashkë me SHBA-në në luftën e grupit të armatosur në Siri dhe Irak.

Megjithëse Presidenti Donald Trump ka deklaruar në dhjetor se "misioni është përmbushur", Pompeo ka thënë se tërheqja e trupave ka qenë "parimisht një ndryshim taktik, jo ndryshim misioni".

Koha InfraRed

Koha, e premte, 8 shkurt 2019

RAZIJE JONUZI & ZARIJE JONUZI ÇELIKU

Shijet që ndajmë së bashku

Dy motra binjake që i shihni secilin mëngjes në ekranin televiziv ALSAT M. Risi dhe atraktivitet para së gjithash. Ndonëse tregojnë shumë për të tjerët dhe të ftuarit që kanë, ka ardhur koha të njihemi bashkë se kush janë Razija Jonuzi dhe Zarija Jonuzi Çeliku...

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Ju tashme jeni dy motra të njohura për opinionin publik. Si ndiheni në këtë rast me njëra - tjetrën?

XAKA: Në fakt, të qënurit person publik, nuk e ndryshon aspak lidhjen e ngushtë që ne kemi si motra, sidomos kur mendon faktin që jemi edhe binjake. Lidhja e veçantë që karakterizon binjakët është edhe ajo fjolla magjike, e cila na ka lidhur, na lidh dhe do të na lidhë gjithmonë me njëra - tjetrën.

RASKA: Sidoqoftë, me gjithë të përbashkëtat tona, ne plotësojmë njëra-tjetrën pikërisht nëpërmjet mendimeve dhe koncepteve të ndryshmeve individuale, të cilat janë pjesë e çdo qenieje njerëzore. Mendimi ndryshe është pjesë e të përbashkëtës sonë.

KOHA: Ju flisni tani mbi individualitetin tuaj njerëzor, si pjesë e shëndetshme brenda të qënurit binjake. A e mendoni këtë fakt si një rregullator të natyrshëm të marrëdhënies njerëzore në përgjithësi?

RASKA: Padyshim që po. Secili nga ne, parë këtu në një plan më të gjerë njerëzor, si në rrethin e ngushtë familjar, në shoqëri, por edhe atëherë kur qarja e parë në jetë përjetohet së bashku, sikur ndodh tek binjakët, e ka të nevojshëm zhvillimin e vazhdueshëm të elementit individual, ashtu të pavarur nga çdo element tjetër i përbashkët. Është pikërisht ky individualitet, kjo shtysë e përhershme që buron nga vetë legjitimiteti i qenies njerëzore mbi rruzullin tokësor, i cili, pasi pranohet si i tillë, përmbledh dhe rregullon natyrshëm çdo marrëdhënie tonën si motra. Dashuria dhe lidhja shpirtërore ndaj njëra-tjetrës, mirëkuptimi mbi të ndryshmen e njëra – tjetrës e tejkalon çdo ndasi që individualiteti ynë i natyrshëm mund të sjellë kurdoherë në rrugëtimet tona të përditshme.

KOHA: A keni ndarë shumë kohë loje në fëmijërinë tuaj?

XAKA: Ne jemi pjesëtarët e fundit të një familjeje me 5 fëmijë, të cilët nuk kanë shumë diferencë moshe ndërmjet njëri-tjetrit. Rrjedhimisht fëmijëria jonë ka qenë në të shumtën e kohës e përbashkët me dy motrat dhe vëllain më të rritur. Natyrisht që fakti i të qenurit binjak ia shton dozën interesante çdo momenti të përbashkët familjar. Sidoqoftë, me kalimin e viteve, kjo edhe për shkak të rrugëtimeve jetësore relativisht të njëjta, koha e kaluar së bashku ka ardhur duke u shtuar. Edhe sot, të rritura dhe me jetë të pavarura siç jemi, kalojmë mjaft kohë duke luajtur, qeshur, ngacmuar njëra-tjetrën. Kemi mundur kështu të ruajmë përherë sado pak nga fëmijëria jonë e dikurshme.

KOHA: Keni qenë përherë mbrojtëse të njëra-tjetrës?

RASKA: Në fakt, jo me çdo kusht. Ne jemi rritur në një familje, ku mendimi racional, i pavarur, ka patur peshën kryesore në gjykimin e përgjithshëm të gjërave. Ne mendojmë që mbrojtja më e madhe mes nesh ndodh atëherë, kur objektiviteti në gjykimin dhe parashtrimin e çdo situate, rritet drejt një komunikimi të shëndetshëm njerëzor, duke u bazuar kështu jo vetëm në faktin e të qenurit motra. Pikërisht ky mendim objektiv, i mbushur me dashuri të patjetërsueshme njerëzore, është edhe mbrojtja më e fortë që ne mund t'i japim njëra-tjetrës. Ky dualitet i rëndësishëm jetësor sjell rrjedhimisht edhe një ndërgjegjësim më të madh të vetë qenies sonë, të individualitetit tonë.

KOHA: Ka pasur momente kur keni dashur që mos përziheni në punët e njëra-tjetrës?

XAKA: Natyrisht qe po. Me kalimin e kohës, me çdo hap të hedhur drejt një pjekurie të natyrshme njerëzore individuale, rriten edhe ato momente të vetëpërmbajtjes përkundrejt çdo situate që mund të kemi në përditshmërinë tonë.

RASKA: Si motra, ne së pari jemi munduar gjithmonë të jemi shoqe të mira të njëra-tjetrës, mbështetëse të mendimeve dhe gjykimeve tona, paçka se ato mund të jenë edhe të ndryshme. Vetë natyra njerëzore e kërkon shpeshherë një lloj tehu të padukshëm distance, por që shpeshherë qëllon shumë i shëndetshëm edhe në marrëdhënien mes nesh si motra.

KOHA: Çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan motrat Jonuzi?

Kjo është një pyetje që ne mund t'i përgjigjemi lehtësisht vetëm me një fjalë: Shumë!

KOHA: Ndodh që grindeni? Për çfarë?

RASKA: A grindemi ne me njëra-tjetrën? (Qesh). Hmmm, patjetër që po. Mendimet, botëkuptimet, gjykimet tona sa janë të përbashkëta, aq edhe ndryshojnë. Unë në përgjithësi nuk kam shumë durim, XAKA i merr gjërat me shtruar, më ngadalë. Në këtë rast edhe "grindja" është e programuar (Qesh).

XAKA: qesh gjithashtu dhe shton: Ky fakt e forcon me shumë lidhjen e veçantë mes binjakeve.

KOHA: Xaka, ti je tashmë edhe nënë e një vajze pothuajse dy vjeçare. Si mund ta përmbledhësh me pak fjalë ndjesinë përkatëse?

Të qenurit prind, nënë i jep jetës së mëparshme një relativitet të natyrshëm. Lidhja e fortë që prindi në përgjithësi, por sidomos nëna në veçanti ndjen ndaj fëmijës, i jep shumë gjërave të mëparshme një dritëhije tjetër, i vendos shumë mendime, gjykime apo edhe vlerësime të dikurshme në një plan më afatgjatë, më sublim. Përgjegjësia ndaj anëtarit më të ri të familjes, si një sintezë dhe simbol i natyrshëm i dashurisë mes dy njerëzve, është një mrekulli më vete, është një tërheqje e përhershme, shtysë e vazhdueshme për të përballuar çdo të papritur, çdo vështirësi që buron pikërisht tek të qenurit prind, nënë. Ekzistenca e vajzës sonë, gëzimi i të qenurit prindër të Gonxhes, i ka dhënë jetës sonë të përbashkët padyshim një burim energjie të pashtershëm.

KOHA: Si është Raska si teze?

Tezi Raska e do shumë Gonxhen, sikurse edhe gjithë nipërit e mbesat e tjerë. Unë i gëzohem çdo momenti që koha ma lejon t'i kaloj me to, sepse ndër të tjera kështu kam rastin t'i ndjek nga afër në zhvillimin e tyre, formimin e tyre të përhershëm njerëzor. Të qenurit teze apo hallë është padyshim një përgjegjësi e veçantë dhe shumë e dëlirë. Padyshim një ndje-

si shumë e bukur njerëzore, që të mbush me krenari të përhershme.

KOHA: Të kthehemi tani përsëri pak tek ju të dyja. A mund të thoni që njihni shijen e njëra-tjetrës?

RASKA: Mendoj që binjakët në këtë rast kanë një lloj përparësie të vetëkuptueshme në lidhje me njohjen e shijeve të motrës, apo vëllait. Rrjedhimisht edhe ne ndajmë mjaft shije të përbashkëta në tërësinë e tyre jetësore, të cilat ia njohim njëra-tjetrës edhe në distancë.

XAKA: Është e vërtetë që ne ia njohim shijen njëra-tjetrës, sidoqoftë jemi përherë të kujdesshme që ta vërtetojmë këtë njohje, duke e pyetur përherë palën tjetër. Ky fakt i jep marrëdhënies tonë një freski të veçantë, e cila na sjell shumë herë të qeshim me njëra-tjetrën.

KOHA: Takoheni shpesh jashtë punës?

RASKA: Natyrisht. Edhe pse përditshmëria jonë rrjedh natyrshëm në individualitetin e saj, ne jemi kurdoherë spontane në takimet tona. Ne e kalojmë kohën gjithashtu me miq e të njohur të përbashkët, ashtu sikurse kemi edhe shumë momente që ia kushtojmë vetëm familjarëve tanë.

XAKA: Tashmë pjesë e ritualit të takimeve tona është bërë edhe marrja e Gonxhes nga kopshti, shpeshherë edhe miket tona të përbashkëta. Këto momente mendoj se janë edhe për Gonxhen veçanërisht të gëzueshme.

KOHA: Si është të punosh me motrën?

XAKA: Është një komoditet i veçantë, sikurse edhe një përgjegjësi më vete. Këtu kemi të bëjmë përherë me një fije të hollë magjike, sidomos kur kemi parasysh faktin që jemi binjake.

RASKA: Ama, edhe pse ia njohim vetes shumë gjëra, marrëdhënia e përbashkët në punë, ka zbuluar shpeshherë edhe anë të panjohura tonat, të cilat në momentet e një përditshmërie ekskluzivisht familjare, ndoshta mund të kalonin pa u kuptuar.

KOHA: Si e vlerësoni faktin që ndani të njëjtin profesion me njëra-tjetrën?

XAKA: Ne në fakt nuk kemi profesione të përbashkëta, paçka se ndajmë shumë kohë me njëra-tjetrën para ekranit. Specifikat e profesioneve tona të ndryshme ne mundohemi t'i sjellim gjithmonë drejt një emëruesi të përbashkët në çdo mëngjes, të cilin ne e ndajmë me publikun që na ndjek.

KOHA: Çfarë do të ketë të re nga ju të dyja në të ardhmen?

RASKA: Besoj se shumë. Zbulimin e tyre do t'ja lëmë një interviste të ardhshme.

XAKA: Ide e mirë kjo, Raska!

BLEONA QERETI
TË JETOSH MES DY VENDEVE

Pop diva, Bleona Qereti vjen në një bisedë ekskluzive ndryshe nga herët tjera. Ajo për InfraRed të gazetës KOHA tregon alfabetin e saj nga A deri në Zh për të treguar shumë gjëra që më parë nuk keni arritur të lexoni për të. Bleona karrierën e ka të fokusuar në arenën ndërkombëtare, por rrëfimin e saj e lexojmë së bashku...

Koha — Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: A, si artist/e... Çfarë "emri" ka artisti brenda teje?

Artist, është identiteti im.

KOHA: B si Bleona...mamaja jote sa është e lidhur me ty dhe çfarë do ti thuash sot përmes kësaj interviste?

Faleminderit për të gjithë sakrificën që ka bërë për mua. Dashuria e saj e pakondicionuar nuk ka kufi dhe çfarëdo që të bëj unë në këtë jetë për të nuk ia shpërblej dot. Love you ma.

KOHA: D si dashuria... A mban një emër të përveçëm dashuria jote?

Jonny.

KOHA: F si fitorja... Cilën konsideron fitoren tënde më të madhe deri tani?

Transformimin e karrierës time në karrierë internacionale.

KOHA: G si gëzimi... Cili ka qenë gëzimi më i madh që u ke falur prindërve të tu?

Dashuria, unë e pafundme për ta!

KOHA: I si instinkti... E ndjen kur diçka do ecë mbarë apo kur dikush mundohet të bëjë hile?

Gjithmonë!

KOHA: J si jeta... Çfarë do të doje të mos mungonte kurrë në jetën tënde dhe çfarë do të doje të mos e provoje kurrë në jetë?

Dashuria nuk do të doja të më mungonte kurrë dhe nuk do doja të provoja humbje (vdekje) të njerëzve të zemrës.

KOHA: K si këngë...më trego pak për këngët që ke lançuar, sa janë pëlqyer dhe çfarë ka në vazhdim?

"I don't need your love", është aktualisht numër 3 në Billboard për një artist pa mbështetjen e asnjë kompanie muzike është arritje shumë e madhe. Kështu jam shumë shumë krenare. Kurse, për sa i takon këngës "Monster", do të thosha se është një film i metrazhit të shkurtër dhe është debutimi i dytë i imi si regjisore pasi ideja ka qenë e imja për të hedhur dritë mbi fenomenin që po ndodh në trojet shqiptare që shumica e vajzave tona kanë zgjedhur paratë në vend të dashurisë së vërtetë dhe lirisë së tyre si qenie njerëzore. Janë thjeshtë zogj të mbyllur në kafaz. Jo të gjitha sigurisht. Kënga është aranxhuar nga Timbaland & Roccstar. Kënga do të jetë kolonë zanore e serialit televiziv "Paper empire". Në videon e "Monster" gjërat janë bërë me idenë për të qenë këngë filmi. "Monster" do fillojë të futet në toplistat botërore, pasi unë të përfundoj promovimin e "I don't need your love". Para një jave, ka dalë edhe një këngë tjetër që unë e kam kënduar në italisht dhe është një 'cover' i këngës së famshme "Su di noi" të këngëtarit të njohur Puppo, dhe jam e lumtur që unë e kam risjellë, dhe që më ka komentuar vet ai në Instagram në momentin që e kam publikuar si këngë. Besoj që së shpejti do vij edhe me një këngë shqip. Kjo është një surprizë për fansat. Në përgjithësi, unë kam pasur më shumë sukses se sa që e kam paramenduar me këto balada.

KOHA: L ... L si LA?

LA, është shtëpia ime.

KOHA: M si muzika... E ke nisur rrugën e muzikës që e vogël dhe e di që do të më thuash se muzika është vetë jeta jote... E kam gabim? Të zë ndonjëherë frika se ndoshta keni investuar jo aty ku duhet?

Asnjëherë! Muzika është jeta ime.

KOHA: S si suksesi...kë do konsideroje suksesin tënd më të madh?

Që jam një femër e lirë dhe e pavarur.

KOHA: O...si mami?

Si mami Oli..

KOHA: P si parfumi... Cili parfum të merr mendjen sa herë që del për shooping?

Unë parfumin nuk e ndërroj asnjëherë. Që 15 vjet kam të njëjtin parfum. Emri është sekret sigurisht!

KOHA: Sh si SHBA...si ndihet Bleona në tokën e premtuar?

Absolutist PO! Krenare dhe e lumtur dhe mirënjohëse që jetoj në Amerikë!

KOHA: Sh si shoqëria... Më kanë thënë se je tip shumë i shoqërueshëm. E vërtetë është?

Sigurisht po! Unë gjithmonë në një marrëdhënie të re hyjë me zemër të hapur. Është mënyra më e mirë për të qenë e lumtur. Dhe sigurisht kam pasur dhe lëndime nga zemra ime e mirë por kjo nuk do të thotë që mënyra e vetme e jetesës të jetë me zemër të mbyllur! Unë kam zgjedhur dashurinë!

KOHA: T si Tirana... Do doje të jetojë në Tiranë, ku mund edhe të bashkëpunoje edhe me artistë të tjerë e ti jepje pse jo një shtysë për të ecur akoma më shumë?

Sigurisht po! Po momentalisht jetoj midis dy vendeve LA dhe Tirana.

KOHA: V si vëllai/vëllezër....Ti ke një të tillë, të mbështesin apo është tipik burrë shqiptarë që gjen gjithmonë diçka për zënka?

Vëllai është gjysma tjetër e imja! Dhe shoku më i mirë!

KOHA: Z si zemra... Zemrën, si e ke sot, bosh apo plot?

Bosh...



Rita Ora me një tjetër sukses

Muzika e saj dëgjohet gjithandej, por këtë herë "Soul Survivor" e Rita Orës është kthyer në himn. Këngëtarja e famshme me origjine nga Kosova dhe Serena Williams janë protagonistet e reklamës më të re të kompanisë "Bumble" për Super BoUl. Bumble, aplikacioni cili inkurajon femrat të krijojnë miq në internet, dhe të dalin në takime ka zgjedhur 28 vjeçaren dhe tenisten e njohur për fushatën "The Ball is in Her Court". Duke e konsideruar si këngë shumë të rëndësishme për të, nëpërmjet një postimi në Instagram Rita Ora është shprehur e nderuar që "Soul Survivor" u përzgjodh për këtë reklamë. Me muzikën e Ritës në sfond, në video-reklamë shihet ikona e tenisit dhe momentet kur ajo e ka marrë iniciativën duke bërë hapin e parë,si dhe triumfet e saj nga e kaluara.

Rihanna e 140 milionë dollarëve

Ajo e nisi karrierën në moshën 16-vjeçare, ndërsa tani është një nga këngëtaret më të suksesshme e sigurisht më të pasura. Rihanna falë albumeve të saj ka arritur të sigurojë 140 milionë dollarë, pa llogaritur koncertet. Por, përveç muzikës, Rihanna pati shumë bashkëpunime me marka të njohura dhe pjesëmarrje në filma. Koleksioni i saj "FentyxPuma" u shit brenda disa orësh, ndërkohë këngëtarja nuk ka ndërmend të ndalet as në biznes.

GRANIT ZEQIRI - READI

Muzika, biznesi "më i rrezikshëm" për momentin

Granit Zeqiri apo i njohur me emrin e artit READI, për momentin është një nga reperët më të përfolur dhe më të suksesshëm në skenën shqiptare. Djaloshi nga Besiana e Kosovës vjen në një bisedë për InfraRed të gazetës KOHA duke treguar arsyet e shkëputjes dhe rikthimit në muzikë

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI



KOHA: Nga ju vjen tërë kjo energji për punë, pasi që jeni kohë të gjatë në skenën muzikore? Jeni një kohë të gjatë në skenën e repit në Kosovë....

Diçka që e kam pasion dhe dhunti prej Zotit e bëj me zemër e me shumë qejf po energjinë më së shumti më japin dëgjuesit e mi, përkrahësit e pikërisht ata që më mbajnë në muzikë.

KOHA: Çka ka ndryshuar me repi i atëhershëm me repin e sotëm?

Nuk jam edhe aq "old school" që me fol për repin e atëhershëm po mundem të them që gjatë kohës që kam bë hip-hop e deri më sot kanë ndërruar shumë gjëra.

KOHA:Si funksionon OnRecords, pasi që kënga e fundit u bë hit menjëherë?

ON Records i ka producentët dhe menaxhimin On top që prej aty dalin edhe ecin super e në këtë rast jam dhe unë që po japim maksimumin për këtë projekt.

KOHA: Sa është vështirë që një i ri me hi në labelin që je pjesë tashmë?

Vështirë është nuk mundem me thënë që është lehtë, sepse duhet shumë punë e angazhim e përkushtim në muzikë me e ndjek ëndrrën deri në fund që mos dorëzohem, por duhet të kemi edhe talentin se pa talent nuk të merr askush në menaxhim, muzika konsiderohet si një prej bizneseve më të rrezikshme sot.

KOHA: A po e ndjeni këtë rrezik?

Jo.

KOHA: Pse zakonisht në skenën e rapit po bëhen kaq shumë "dissa"?

Muzika hip-hop është muzika apo kultura më e zhvilluar në çdo shtet të botës, e dissa-at janë pjesë e saj, kanë qenë dhe kanë me qenë gjithmonë, ikonat e saj kanë bë diss-a e ju kanë bë diss-a.

KOHA: A keni pasur ndonjëherë probleme sepse shpesh ka pasur thashetheme që ke pasur?

Kam pas disa herë!

KOHA: Si i vlerësoni reperat e Shqipërisë. Nuk janë shumë, janë pak, por edhe ata që janë nuk janë edhe aq të mirë sikurse tek ne?

Mendoj që është puna e dialektit këtu pak por ka edhe repera të mirë atje po tek ne në Kosovë është më e zhvilluar.

KOHA: Kalojmë tek koncertet, sa i kërkuar jeni?

Kam qenë edhe më herët i kërkuar në shumë vende, por nuk e kam ndjerë veten gati pasi edhe nuk kam pasur shumë këngë por tash gradualisht do të filloj edhe me koncerte.

KOHA: A jeni person që e aplikoni fenë?

Me raste po.

KOHA: Çka mundemi me prit prej Readit gjatë këtij viti?

Projekte të forta e tjera e tjera...

KOHA: A keni menduar për të bërë ndonjë album të ri?

Momentalisht kam një album dhe një mixtape që kanë dalë, albumi në vitin 2012 kurse Mixtapei në 2017. Pse jo dhe një tjetër të kem i kam shumë në qejf por më vonë njëherë jo.

KOHA: Ku mendoni se keni gabuar gjatë karrierës. Keni gabuar shumë pak?

Po mendoj që kam gabuar në shumë momente gjatë karrierës, nuk jam përkushtuar nganjëherë sa duhet dhe kam humb shumë mundësi të ndryshme në raste të ndryshme, mirëpo gjërat kanë filluar të bien në vend të vet falë Zotit dhe atyre që besojnë në punën time.

KOHA: A e shihni vetën në politikë sikurse disa repera të tjera të Kosovës?

Jo se besoj.

Ermal Meta rikthehet në Sanremo 2019

Një vit pasi u shpall fitues i festivalit të muzikës italiane Sanremo 2018, kantautori shqiptar Ermal Meta do të rikthehet në skenën e Sanremo 2019 si i ftuar special në natën e dueteve. Ai do të performojë ditën e premte më 8 shkurt, një ditë para natës finale në duet me këngëtarin në garë Simone Cristicchi me këngën e tij "Abbia cura di me".

Rikthimi në festivalin e Sanremos, bëhet në një moment të veçantë për artistin shqiptar, i cili sapo ka nisur një tur koncertesh në të gjithë Italinë . Për mediat italiane ai rrëfen se, "pas suksesit të një viti më parë në Sanremo, pranoj të shoqëroj në duet për një natë këngëtarin Simone Cristicchi."

"Kënga e tij më pëlqeu e shumë . Jam një fans i muzikës së Cristicchit. Më pëlqen pena e shpirti i tij muzikor. Pranova menjëherë ftesën , është një zgjedhje që mund ta bëj vetëm për pak persona", u shpreh Ermal Meta. Në drejtimin artistik të këngëtarit të njohur Claudio Baglioni, në Sanremo 2019 mungon gara e kategorisë së këngëtarëve të rinj.

Sanremo 2019 prezantohet për të dytin vit radhazi nga drejtori artistik Claudio Baglioni, që sivjet shoqërohet nga aktorët komikë Virginia Rafelle e Claudio Bisio.

Emri i saj tashmë njihet nga të gjithë, gjeneratat e vjetra e kujtojnë si një nga femrat më me stil që sillte hite, por Lule Bajra nuk ndalet e vazhdon të këndojë e argëtoje shqiptarët ngado që janë me muzikën e saj të bukur shqipe. Jeton në Zvicër por këndon në gjithë diasporën e këtë e thotë edhe në një intervistë për InfraRed të gazetës KOHA

LULE BAJRA
NË HAP ME KOHËN

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Ka vite që je në skenë dhe nuk din të ndalesh?

Unë nuk do të lë këngën sepse e dua dhe është dashuria e jetës time mjekësia ime, nëse ajo më lenë mua nuk kam çfarë të bëj por për momentin nuk do të ndalem, mbi 30 vite jam në skenë dhe shpresoj të jem edhe 30 tjera (qesh).

KOHA: Ku ka qenë gjithë këtë kohë Lulja, na thuaj aktivitetet me të cilat je marrë?

Tashmë e dinë krejt se jetoj në Zvicër dhe këtu jam mjaft e angazhuar në mbrëmje e koncerte gjithandej nga jetojnë shqiptarët, me punë me obligime tjera, thjeshtë jeta këtu është shumë dinamike.

KOHA: Kush është Lulja për ato që nuk të njohin, na trego anën e panjohur tënden ndonjë sekret që deri më sot nuk e ke zbuluar?

Për ata që nuk më njohin, shumë e dashur dhe e ndjeshme, energjike sepse punoj shumë e besoj se jam nënë e mirë e Leonit 18 vjeçar, shumë të edukuar dhe të sjellshëm, jam poashtu shumë komunikative, i takoj një gjenerate të mesme dhe eci në hap me kohën edhe pse në disa raste jam konzervative, jeta nuk është e lehtë sepse të sfidon shumë por ia dal prapë me energjinë e tepruar që kam, sekrete kemi të gjithë por nëse i tregojmë nuk janë më sekrete (qesh).

KOHA: Je një kuzhiniere e mirë?

Nuk jam shumë e talentuar në kuzhinë, pasi jetoj vetëm me djalin tim e nuk është se jemi familje e madhe për atë dhe nuk ziej gjithmonë.

KOHA: Si kalon ditën Lulja pa angazhime muzikore, si është një ditë e juaja nga mëngjesi deri në mbrëmje?

Zgjohem herët shumë dhe bëhem gati për punë e pastaj shkoj në një kurs që kam nisur e më vonë bëhem gati për fitnes, ndodh që drekën dhe darkën të ha me shoqe jashtë por edhe me djalin, më pëlqen të shoh filma në kinema dhe kur kam kohë lexoj shumë. Nuk fle herët edhe pse zgjohem herët.

KOHA: Për çfarë i lutesh Zotit kur bie të flesh dhe kur zgjohesh?

Zotit kur bie të flejë i kërkoj falje për gabimet ose ndonjë mëkat që kam bërë pa vetëdije, i falënderohem që jam gjallë e shëndoshë unë dhe djali dhe për të gjitha të mirat që na ka dhënë, e në mëngjes i falënderohem që jam zgjuar, sepse miliona njerëz bien të flenë e ditën tjetër ndodh që mos zgjohen.

KOHA: Cilat janë befasitë që do sjellësh dhe si planifikon këtë vit?

Viti që shkoi ishte shumë i suksesshëm për mua se kam realizuar dy këngë të reja me klipe, një baladë dhe një këngë ritmike, isha pjesë e koncertit të madh në Londër që organizoi Granit Xhaka ku kam kënduar para mijëra shqiptarëve atje e këtë vit do sjellë një bashkëpunim të ri në trio, kënga është një hit i imi që do vijë në ripërpunim në versionin modern.

KOHA: I ke rënë pishman ndonjëherë që je marrë me muzikë?

Falënderoj Zotin që më ka dhënë talentin, unë asnjëherë nuk i kam rënë pishman që jam marrë me muzikë, e dua dhe nuk mundem pa të e nuk di kur të plakem nëse do më thërrasin për të kënduar. Gjithë stresin e javës dhe nëse kam ndonjë mërzi apo ndonjë problem e largoj përmes muzikës në fundjava.

AVNI HADËRGJONAJ
VAJZA LORENA, KËNGA MË E BUKUR NË BOTË

Është emër i njohur i muzikës, këngëtar i dëshmuar prej shumë vitesh. E kemi dëgjuar prej kohësh, herë me balada të ndjeshme e herë me këngë ritmike. Piktor e këngëtar, bota e Avni Hadërgjonajt po që është gjithë ngjyra. Lexoni intervistën me të dhënë për InfraRed të gazetës KOHA

KOHA: Ku je, ku ke humbur?

E vërtete që ka kohë që nuk kam qenë prezent në muzikë, nuk kam realizuar ndonjë këngë a projekt që do të më mbante më pranë me publikun. Kjo nuk do të thotë se nuk kam qenë në kërkim të materialeve muzikore. Ndërkohë, jetoj në Suedi ku kam ndërtuar jetën time.

KOHA: Pse s'të kemi parë prej kohësh me ndonjë projekt të ri muzikor?

Sigurisht, arsyet e këtij largimi lidhen edhe me ca gjëra të jetës personale. Gjithsesi, do të kthehem dhe uroj që projekti i ri ta gjej dëgjuesin dhe admiruesin e vetë.

KOHA: Kënga që e konsideron hit të karrierës?

Unë kam disa këngë, e gjithashtu edhe albume muzikore. Karriera ime është e mbushur me këngë të zhanreve të ndryshme, por ajo që më pëlqen e që gjithashtu mendoj se ka marrë epitetin e hitit është kënga me titull "Nuk të njoh", që është projekt i para dy vitesh.

KOHA: Je edhe piktor. Temat që i dominojnë veprat tua?

Unë kam studiuar për pikturë dhe arti në përgjithësi është dashuria ime e madhe. Temat janë nga më të ndryshmet, pjellë e imagjinatës sime artistike. Shpesh janë sureale.

KOHA: Po jetës tënde kush i jep ngjyre?

Familja, vajza ime Lorena që është piktura dhe kënga më e bukur në botë.

KOHA: Si është të jesh baba i një vajze dhe sa kuptim i jep Lorena jetës suaj?

Siç e thash, Lorena është dashuri e madhe. Jemi të bekuar me të, pasi është një fëmijë i shëndetshëm, i talentuar dhe shumë i këndshëm.

KOHA: A po e trason e bija rrugën tënde?

I pëlqen muzika dhe studion për piano. Është shumë e talentuar dhe e përkushtuar.

KOHA: Avni jeton larg Kosovës, a ndjen mall për vendlindjen?

Sigurisht që ndjej mall për vendlindjen, për Kosovën time të dashur. Të jetosh larg vendlindjes nuk është e lehtë, sepse e ndjen nevojën e të qenit pranë njerëzve të dashur për ditë.

KOHA: Ushqimi tradicional që e shijon më shumë?

Nuk jam nga ata njerëz që konsiderohen gurman. Por, gjithsesi shijoj me kënaqësi disa lloje ushqimesh, ndër to edhe tradicionale. Kryesojnë pitet e flia. Të gjitha ushqimet e përgatitura nga duart e nënës shijojnë më shumë.

KOHA: Të shohim me shumë stil, po cili është elementi që e karakterizon më fuqishëm llukun tënd?

Stili im varion nga ai minimalist në atë ekstravagant. Në përditshmëri përgjithësisht vishem thjeshtë dhe praktik ndërkaq në skenë më pëlqen të jem edhe ekstravagant, ndonëse kjo varet edhe nga natyra e këngës.

KOHA: A do ti kthehesh këngës?

Patjetër, shumë shpejtë.

KOHA: Diçka që nuk është thënë, e që e ndjen se duhet të thuhet?

Të përpiqemi të bëhemi njerëz të mirë, të duam sinqerisht dhe t'u zgjasim dorën atyre që kanë nevojë. *(B.R)*

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 42/2019

për punësimin e 5 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komisionin e Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë "për vendet e punës në vijim:

1. KHV0101B03001 Koordinator i njësisë organizative për çështje të përgjithshme dhe normative, Sektori për punë të përgjithshme dhe normative — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat juridike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 62.000,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2019 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

2. KHV0101B04002 Udhëheqës i njësisë për çështje financiare — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Kushtet shtesë:
- të ketë tre vjet përvojë punë në sferën e financave

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 54.000,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2019 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

3. KHV0101V01007 Këshilltar i pavarur për dhënien e lejeve dhe miratimet, sektori për financa korporative — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- nilevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkencat ekonomike ose juridike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 54.000,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2019 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

4. KHV0101V04001 Inspektor më i ri për kontroll dhe mbikëqyrje, Sektori për mbikëqyrjen e tregut të kapitalit — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat ekonomike ose juridike
- me ose pa përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 32.000,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2019 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

5. KHV0101V02004 Këshilltar i lartë për auditim të brendshëm, Njësia për auditim të brendshëm — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat ekonomike ose juridike
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Kushtet shtesë:
- të ketë kaluar trajnimin dhe të ketë kaluar provimin për një auditor të brendshëm të certifikuar në sektorin publik në kuadër të Programit për marrjen e provimit për një auditor të brendshëm të certifikuar ose për të mbajtur një certifikatë të auditimit të pranuar ndërkombëtarisht
- të ketë të paktën dy vjet përvojë pune në auditimin e brendshëm ose të jashtëm

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 46.000,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2019 janë të parapara: Turk(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

FILMI KOSOVAR 'NË MES' PJESË E EDICIONIT TË 69-të TË BERLINALES

24 filma nga 17 vende pritet të shfaqën në 2019-të, ku filmat e metrazhit të shkurtër pritet të garojnë për disa çmime gjatë edicionin e 69-të të "Berlinale", si " Ariu i artë dhe i Bronztë", " Audi film të shkurtër" dhe nominimi për "Filmin më të mirë evropian të metrazhit të shkurt"

Është hapur të enjten në Berlin edicioni i 69 i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit, i njohur edhe si Berlinale. I konsideruar si një ndër festival më të rëndësishme të industrisë filmike në botë, ky festival mbledhë produksionet më të mira dhe figurat botërore të filmit.

E veçanta e këtij edicioni të Berlinales, është se pjesë e tij është edhe filmi kosovar, "Në mes" i metrazhit të shkurtër me regji të Samir Karahodajt.

Filmi "Në mes" do të jetë pjesë e garës së ndërkombëtare të filmave të shkurtë "Berlinale Shorts", ndërsa sipas programit premiera e filmit në Berlinale do të jetë me 12 shkurt.

Filmi, ndër të tjerash nëpërmjet personazheve, portretizon marrëdhënien dhe solidaritetin në mes vëllezërve; sakrificën dhe vendosmërinë e prindërve për të mbajtur harmoninë brenda familjes.

Filmi është prodhim i SK Pictures, i mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës, Banka për Biznes, Komuna e Prizrenit, Komuna e Prishtinës dhe DokuFest.

Me këtë rast Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë, ka uruar regjisorin e këtij filmi Samir Karahoda.

Në urimin e ambasadës shkruan: "Urime për Samir Karahoda i cili do të shfaqë filmin e tij të metrazhit të shkurtër "Në Mes" në Berlinale të këtij viti. Ky është një hap i madh përpara për regjisorët kosovarë. Ne po i mbajmë shtrënguar duart, duke i'u dëshiruar fat! 24 filma nga 17 vende pritet të shfaqën në 2019-të, ku filmat e metrazhit të shkurtër pritet të garojnë për disa çmime gjatë edicionin e 69-të të "Berlinale", si " Ariu i artë dhe i Bronztë", " Audi film të shkurtër" dhe nominimi për "Filmin më të mirë evropian të metrazhit të shkurt", njofton Ambasada Gjermane.



"Dheu i ofshamës", sjell tmerret e luftës në Kosovë

Tridhjetë e dy persona të moshave dhe etnive të ndryshme kanë kujtuar përjetimet e tyre, sidomos ato të kohës së luftës së fundit në Kosovë, në librin "Dheu i ofshamës", që është promovuar të mërkurën mbrëma në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Rrëfimet janë shoqëruar me piktura dhe fotografi që dokumentojnë historitë familjare të anëtarëve të dy grupeve me 16 anëtarë, që gjatë viteve 2016-2018 ishin pjesë e trajnimeve të organizatës joqeveritare "Aksioni Kundër Dhunës dhe Ndërtimi i Paqes"(ANP) në kuadër të projektit "Ballafaqimi me të kaluarën në Kosovë", të mbështetur nga KURVE Wustrow – Qendra për Trajnime dhe Rrjetëzim Kundër në Aksionin e Padhunshëm – të përkrahur nga Ministria Federale për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik e Gjermanisë.
Në "Dheu i ofshamës", njerëz nga pjesë të ndryshme të Kosovës tregojnë rrëfimet e tyre në kohë të vështira, për mbijetesën dhe për kujtimet që nuk iu ndahen edhe pothuajse dy dekada pas përfundimit të luftës. "Na flasin për veten e tyre, familjet, miqtë, të njohurit dhe të gjithë të tjerët që takuan në këtë rrugëtim për të mos u parë më kurrë me ta. Përshkruajnë ngjarje historike në kohëra të ndryshme kohore, e në mënyrën të veçantë na sjellin në kujtesë vitet 1998-99, kohën e luftës së fundit në Kosovë", thuhet në anën e pasme të kopertinës së librit.

Lidhja e Shkrimtarëve shpall konkurs letrar për manifestimin 'Ora e Lirisë'

Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës ka hapur konkurse letrar për krijime më të mira të cilat do të prezantohen në manifestimin letrar-artistik "Ora e Lirisë" që organizohet nga kjo shoqatë në fillim të marsit të këtij viti dhe mbahet në kuadër të "Epopesë së UÇK-së".

Përmes një njoftimi LSHK-ja bën të ditur se temat e krijimeve nuk janë përcaktuar, por organizatorët preferojnë atë të luftës, ndërsa do të ndahen edhe tri çmimet për krijimet më të mira dhe prezantim të poezive në ndryshme.

"Manifestimi letrar-artistik "Ora e Lirisë" i LSHK-së, që mbahet në kuadër të "Epopesë së UÇK-së" në shenjë të heronjve e të dëshmorëve të kombit, tashmë do të jetë tradicional. Sivjet po shpallim një konkurs letrar për këtë manifestim të rëndësishëm dhe presim vlera të reja nga krijues të të gjitha gjinive", thuhet në njoftimin e LSHK-së.

Murakami - shkrimtari me jetë ushtarake

(Shkruan pa u gdhirë,vrapon,noton,dëgjon muzikë e sheh filma)

Shkrimtarët janë krijesat më të çrregullta në botë. Ata përgjithësisht janë tipa të çuditshëm, gjithmonë të ngutur, shumë me një jetë private të përfolur dhe sidomos pak të rrëmujshëm.

Por, "përjashtimi forcon rregullin"-thotë Aristoteli, e duket që përjashtimi më klasik në këtë rast është Haruko Murakami, bashkëkohësi ynë. Japonezi konsiderohet sot, si shkrimtari më i njohur në botë. Nominuar disa herë për "nobel" vitet e fundit, ai është përkthyer më shumë nga të gjithë kolegët e tij të famshëm të gjallë, Kundera, Kadare, Houllenbek etj, në plot 51 gjuhë.

Ofertuesit e interesuar për pjesëmarrjen në procedurë me kërkesë për grumbullim të ofertave, informata më të hollësishme për lëndën e kërkesës, kriteret minimale, kërkesat dhe mënyra e parashtrimit të ofertave mund të marrin në dokumentacionin shtesë i cili mund të merret çdo ditë pune nga ora 10:00 deri 13:00 në arkivin e SHMQSH "Shaip Jusuf" rr. Vashingtonska nr.44, komuna Shuto Orizare, Shkup.

Sipas nenit 21 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve të nxënësve të shkollave të mesme, subjektet juridike duhet t`i plotësojnë kushtet minimale të përshkruara në të njëjtin nen.

Oferta e ofertuesit e cila nuk i plotëson kushtet minimale mund të refuzohet nga ana e komisionit si e papranueshme.

Kriteri për dhënie të marrëveshjes për realizim të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira është: çmimi më i ultë

Ekskursionet do të realizohet vetëm nëse ka numër të mjaftueshëm të nxënësve të paraqitur.

Ofertat e pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Hapja e ofertave realizohet pa prezencën e ofertuesve. Ofertat me dokumentet e duhura të parashtrohen deri te Komisioni për realizim të procedurës për ekskursione të nxënësve, në arkivin e shkollës ose përmes postës në adresën: SHMQSH "Shaip Jusuf", rr.Vashingtonska nr.44, Shkup.

Shpallja zgjat 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të tij.

Ofertat në afatin e dhënë është e nevojshme të jenë të arritura në arkivin e shkollës. Çdo ofertë e arritur pas afatit përfundimtar gjegjësisht pas skadimit të pesë ditëve të punës do të llogaritet si e vonuar dhe nuk do të jetë lëndë për shqyrtim.

Komisioni për zbatim të procedurës për realizim të ekskursioneve
të nxënësve dhe aktivitete tjera të lira

FIFA - RANGLISTA

MAQEDONIA DHE SHQIPËRIA SHËNOJNË RËNIE, KOSOVA NGJITET NJË POZITË

Maqedonia për momentin mban pozitën e 71 dhe kjo rënie erdhi si rezultat ecjes së madhe të kampionit të Azisë, Bahreinit edhe për plotë 38 pozita. Përfaqësuesja e Kosovës ka përparuar për një pozitë në këtë renditje. Kombëtarja e Shqipërisë ka pësuar rënie në renditjen më të re të FIFA-s. Kuqezinjtë e shohin veten në pozitën e 61

Koha — Fisnik NUHIU

Shkup, 7 shkurt - Ashtu si çdo muaj, FIFA ka publikuar edhe njëherë renditjen e përgjithshme të pozicionimit të përfaqësuesve të gjithë botës, ku përfshihet kontinenti Europian (UEFA), konfederata amerikanolatine (CONMEBOL), konfederata amerikano veriore dhe qendrore, por edhe karaibike (CONCACAF), konfederata afrikane (CAF), konfederata aziatike (AFC) dhe konfederata oqeanike (OFC). Në bazë të pikavarazhit dhe ndeshjeve të zhvilluara, listohet edhe klasifikimi i azhornuar dhe, duke parë se në këtë periudhë shumë shtete nuk marrin pjesë në aktivitet, atëherë shërben më shumë për atë kontinent ku është luajtur. Reprezentacioni i Maqedonisë në futboll në muajin e parë të vitit nuk kishte kurrfarë aktivitete, ashtu që në renditjen më të re të FIFA-së, të publikuar ditën e enjte ka shënuar një rënie për tri pozita. Maqedonia për momentin mban pozitën e 71 dhe kjo rënie erdhi si rezultat ecjes së madhe të kampionit të Azisë, Bahreinit edhe për plotë 38 pozita. Përfaqësuesja e Kosovës ka përparuar për një pozitë në këtë renditje. "Dardanët" e shohin veten në pozitën e 130, ndërsa muajin e kaluar ishin në atë të 131. Verdhekaltrit kanë 1113 pikë, ndërsa gjenden përpara Letonisë dhe prapa Malauit. Kosova pati paraqitje brilante në vitin 2018, të cilin e mbylli pa humbje dhe me këtë rast regjistroi një ngritje të madhe në renditjen e FIFA-s. Kombëtarja e Shqipërisë ka pësuar rënie në renditjen më të re të FIFA-s. Kuqezinjtë e shohin veten në pozitën e 61-të, një pozitë më poshtë sesa në muajin paraprak. Skuadra e Christian Panuccit ka 1372 pikë, sa kishte edhe muajin e kaluar, ndërsa gjendet përpara Burkina Fasos dhe prapa Bolivisë. Shqipëria nuk e pati një vit të mirë në 2018 duke dështuar në Ligën e Kombeve. Ndryshime nuk ka në krye të ranglistës të cilës i prin Belgjika e përcjell nga Franca, Brazili, Kroacia dhe Anglia. Falë suksesit të bujshëm të arritur në Kupën e Azisë, Katari arrin rekordin historik (falë edhe golashënuesit Almoez Ali Zainalabiddin), duke u ngjitur në vend të 55-të dhe "kapërcyer" plot 38 pozicione.

Shkupi nis me fazën e fundit të përgatitjeve

Shkup, 7 shkurt - Edhe pas kthimit nga Antalia, ku skuadra e FC Shkupit zhvilloi fazën kryesore të përgatitjeve, shiu si duket është bërë pjesë e pandashme e ekipit, që e kishte përcjellë në kohën më të gjatë të përgatitjeve. Pas dy ditëve pushim që trajneri Umit Karan u kishte dhënë futbollistëve, të mërkurën pasdite ekipi i është kthyer obligimeve, duke zhvilluar seancën e parë stërvitore, por duke mos ngarkuar shumë fizikun, pasi që sot kishte vrapime të lehta. Ekipi nga dita e nesërme do të kryej stërvitjet në terrenet ndihmëse të FFM-s, për të shfrytëzuar në maksimum kushtet që ofrojnë fushat e këtij kompleksi sportiv. Të përkujtojmë se sezoni pranveror fillon me 17 shkurt, ndërsa ekipi bardhekaltër ndeshjen e parë e luan në Kratovë kundër Sileksit.

Duka zgjidhet anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka është zgjedhur anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s për një mandat katër vjeçar. Në Romë, u mbajt Kongresi i 43-të i UEFA-s dhe ndër të nominuarit për një vend në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s ishte edhe Duka. Duka arriti të bëhet shqiptari i parë që merr një pozitë kaq të lartë qeverisëse në kuadër të këtij organi qeverisës të futbollit evropian. Ai e fitoi këtë pozitë, pasi i mori plot 36 vota nga 55 të mundshme.

Willemi nxjerr në shitje Avdijajn

Aventura e sulmuesit të Përfaqësueses së Kosovës, Donis Avdijaj te skuadra holandeze Willem II ka marrë fund. Mediumet holandeze kanë raportuar se drejtuesit e klubit tashmë e kanë nxjerrë në shitje Avdijajn dhe se gjatë kësaj jave mund të zyrtarizohet transferimi i tij diku tjetër. Avdijaj në fund të muajit dhjetor është suspenduar nga klubi për shkak të thyerjes së rregullave dhe gjithashtu muajin e shkuar është larguar nga kampi stërvitor në Spanjë për shkak të lëndimit të gjurit. Sipas gazetës "Brabants Dagblad", klubi po kërkon blerës për Avdijajn nëpër Rusi, Poloni, Suedi, Zvicër e SHBA pasi janë ligat e vetme ku afati kalimtar është ende i hapur. Te Willemi tashmë e kanë huazuar sulmuesin e krahut Marios Vrousai nga Olympiacosi, i cili do të mbulojë rolin e Avdijajt deri në fund të këtij edicioni. Avdijaj, 22-vjeçar, para fillimit të këtij edicioni iu bashkua Willemit, me të cilin ekip ka kontratë deri në fund të këtij edicioni me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër. Ai deri më tash ka shënuar tetë gola dhe ka asistuar gjashtë herë në 19 paraqitje në të gjitha garat. Kartoni i tij, vlerësohet rreth dy milionë euro. Avdijaj karrierë ka bërë edhe te Schalke, Roda e Sturmi i Grazit. Ai në vitin 2017 ka debutuar me Përfaqësuesen e Kosovës dhe deri më tash ka gjashtë ndeshje të zhvilluara dhe dy gola të shënuar.

Me 11 qershor hapet "Arena Kombëtare"

Pritjes për të parë një ndeshje në "Arena Kombëtare" po i vjen fundi, madje ka dhe një datë zyrtare dhe një takim të përcaktuar për t'u luajtur në impiantin më të ri në vend. Në 11 qershor, Shqipëri – Moldavi, takimi i vlefshëm për eliminatoret e "Europianit 2020", do të luhet në stadiumin që të gjithë presim. SuperSport ka mundur të mësojë nga burime pranë Federatës se institucioni qeverisës i futbollit shqiptar i është përgjigjur duke i dhënë emrin e stadiumit të ri, kërkesës së UEFA-s, që kërkon paraprakisht vendzhvillimin e ndeshjeve të eliminatoreve për të programuar gjithçka në avancë. Lajmi gjen konfirmim edhe nëse i hedh një sy faqes së Federatës Shqiptare të Futbollit në seksionin ku ndodhet kalendari i ndeshjeve të Kombëtares dhe pikërisht për ndeshjen Shqipëri – Moldavi lexohet "Sheshi Italia", Tiranë. Në këtë mënyrë, mund të jepet e sigurt se maksimumi në muajin qershor "Arena Kombëtare" do të jetë përfunduar dhe funksional, gati për të mikpritur evente futbollistike. Edhe pse nuk ka ende një njoftim zyrtar, kjo do të thotë se me shumë mundësi është gjetur edhe një marrëveshje mes Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Financave për çështjen e rimbursimit të Tatimit të Vlerës së Shtuar sa i përket pjesës së investimit nga Federata në lidhje me stadiumin, një ngërç që kërcënonte të mbante peng përfundimin e punimeve në "Arena Kombëtare".

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësinor

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2, paragrafi 3, paragrafi 8, paragrafi 13 dhe paragrafi 14 të Ligjit për shpenzimet e sektorit publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 27/2014, 199/2014, 27/16, 35/18 dhe 198/18) Neni 22, Neni 23, Neni 24, Neni 25, Neni 26 dhe Neni 27 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 62/05, 106/08, 161/08 , 114/09, 130/09, 149/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187 / 13, 34/14, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 74/15, 129/15, 27 / 16,154 / 2016 dhe 120/18) Rregulloja për sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor nr. 01-2172 / 1 nga data 01.05.2017, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor shpall:

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR - 7/2019
Për punësimin e (5) pesë përmbaruesve për afat të caktuar për periudhën deri më 31 .dhjetor 2019

Për nevojat e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor shpallet shpallja publike për punësimin / ihumalimin e marrëdhënies së punës për 5 (pesë) përmbaruesi për vendet e punës në vijim:

1.Referent i ri për evidencë (statistikore), Njësia për koordinimin e buxhetit, Sektori i Çështjeve Financiare;

2. Bashkëpunëtor i ri për mbrojtjen ligjore teknike, Njësia për Standarde, Sektori për Bashkimin Evropian;

3. Bashkëpunëtor për përgatitjen e projeve të tenderit dhe dokumentacionit të investimeve, Njësia për investime, Sektori për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Investime;

4. Bashkëpunëtor i ri për mbështetje administrativo-operacionale dhe pëlqimeve e të dhënave për përcaktimin e parregullsive në punë, Njësia për çështje profesionale normative-ligjore dhe administrative;

5. Bashkëpunëtor i ri për materien organike të paghënëndëshme, Njësia për ndërtim e sjellë dhe materiet organike të paghënëndëshme, Sektori për Ndërtim Industriale dhe Menaxhimin e Rrezikut.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të jetë shtetas i R. së Maqedonisë
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase
- të jetë një i rritur;
- të kenë afitni të përgjithshme shkollorë për vendin e punës
- me aftësitë e plotësojnë të gjykatës të mos keni qenë i dënuar për mos kryerjen e profesionit, vepërmatësit osë detyrës.

Kandidatët krahas kushtëve të përgjithshme të paraheqitura me Ligj, duhet t'i përmbushin kushtet në vijim:

Për vendin e punës nga pika 1 :

- Arsimimin e larti të mesëm
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohuri aktive të një prej tre gjuhëve me të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)
- me ose pa përvojë pune

Për vendin e punës nga pika 2 :

- Të kenë së paku 180 kredi sipas EKTC ose të kenë të kryer shkallën e VII 1, nga fusha e Inxhinierisë Makinerike, Mjedisi Jetësor, Kimia
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohuri aktive të një prej tre gjuhëve me të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)
- me ose pa përvojë pune
- orari i punës disa nga ora 7:30 /8:30 deri në orën 15:30/ 16:30, orari i punës javore 40 orë nga e hëna deri të premtes;
- paga neto 20.986,00 denarë

Për vendin e punës nga pika 3 :

- Të kenë së paku 180 kredi sipas EKTC ose të kenë të kryer shkallën e VII 1, nga fusha e Mjedisit Jetësor, Pyllëtaria dhe Hortikultura, Shkencat Ekonomike
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohuri aktive të një prej tre gjuhëve me të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)
- me ose pa përvojë pune
- orari i punës disa nga ora 7:30 /8:30 deri në orën 15:30/ 16:30, orari i punës javore 40 orë nga e hëna deri të premtes;
- paga neto 13.140,00 denarë

Për vendin e punës nga pika 4 :

- Të kenë së paku 180 kredi sipas EKTC ose të kenë të kryer shkallën e VII 1, nga fusha e Shkencave Ekonomike, Shkencat Juridike, Administratë Publike
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohuri aktive të një prej tre gjuhëve me të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)
- me ose pa përvojë pune
- orari i punës disa nga ora 7:30 /8:30 deri në orën 15:30/ 16:30, orari i punës javore 40 orë nga e hëna deri të premtes;
- paga neto 20.986,00 denarë

Për vendin e punës nga pika 5 :

- Të kenë së paku 180 kredi sipas EKTC ose të kenë të kryer shkallën e VII 1, nga fusha e Kimisë, Teknologjisë Kimike, Biokimia
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohuri aktive të një prej tre gjuhëve me të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)
- me ose pa përvojë pune
- orari i punës disa nga ora 7:30 /8:30 deri në orën 15:30/ 16:30, orari i punës javore 40 orë nga e hëna deri të premtes;
- paga neto 20.986,00 denarë

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për konkurrim. Kandidatët me fëmijë me aftësi të mëvogël jetësë duhet t'i dorëzojnë dëshmitë për plotësimin e kushtëve në original osë në kopje të vërtetuar nga noteri. Në fletëparaqitjen dëshmitë duhet të jenë e shkruar dhë specifikuar vetëë i punës për të cilën aplikohet. Dokumentacioni i nevojshëm të dorëzohet në Arkivin e Ministrisë, me ërë pëër në adresën e mëpëshme: Prvoto Bogoevska br.2, 1000 Shkup, Ministria e Mjedisit Jetësor dhë Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Burimeve Njerëzore (me shënim "për shpallje nr.7/2019"). Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është tre ditë duke filluar nga dita pas publikimit të shpalljës së dytë dënë. Aplikacioni dhë dokumentacioni i vonë dhë i paplotë nuk do të marrë parasysh. Pas përgjedhjës së kryë kandidatëë e paraqitur për plotësimin e kërë vendëë e punës, kandidatët e përzgjedhur do të fitohë të tëj në një intervistë në ambientë e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhë Planifikimit Hapësinor, pas së cilës do të bëhet përzgjedhja përfundimtare.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhë Planifikimit Hapësinor

Republika e Maqedonisë
Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të neni 46, neni 47, neni 48 dhe neni 49ë Ligjit për shfrytëzim dhë posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhë me mjetet në pronësi të komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15, 21/18) dhë Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 45-1004/1 të datës 5 shkurt 2019, Komisioni për posedim me mjetet e paluundshme dhë mjetet e luundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë, në vijim publikon këtë:

SHPALLJE nr. 1/2019
Për shitjen e parë të mjeteve të luundshme përmes ankandit publik elektronik

I. LËNDA E SHITJES PËRMES ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

1. Lëndë e shitjes janë mjete të luundshme – pronë e Republikës së Maqedonisë edhë atë:

1. Bilonë, derivate për raketa: të raketave kundër breshërit, 7005 copa të klasifikuara + mësh 200 copa të paestandardizuara + mësh 400 paketëmë të zbrazëta me peshë të përgjithshme prej 14.467,39 kg;
2. Derivate në gjendje agregatë të ngurtë ("shëndosësë") 40 copë me peshë të përgjithshme prej 578,8 kg;
3. Derivate për raketa në formë të pëlhurës për raketa kundër breshërit 738,41 kg;
4. Reagenë për raketa kundër breshërit 26,10 kg;
5. Raketa kundër breshërit të kompletuara, të amëbatazhuara, (të vulosura) 10 copë;
6. Raketa kundër breshërit të kompletuara, të paamëbatazhuara, (të pavulosura) 27 copë;
7. Raketa kundër breshërit pjesërisht të kompletuara 46 copë;
8. Raketa kundër breshërit pjesërisht të kompletuara (cilindrues) 23 copë;
9. Koka të raketave kundër breshërit 42 copë;
10. Elementë për raketa kundër breshërit me shfrenësë 252 copë;
11. Koka për raketa kundër breshërit të kompletuara veëëm me kapsulla detonuese 38 copë

të përmbajtura në Vendimin për shitje të mjeteve të luundshme të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 45-1004/1 prej 5 shkurtit 2019.

1.1. Çmimi fillestar:
Çmimi fillestar për ankandin publik elektronik të mjeteve të luundshme 61.500,00 denarë.

1.2. Garancia bankare:
Garancia bankare për sërcozitet të ofertës duhët të ëhumë prej 1.230,00 denarë, gjegjësisht 2% e shumës së vlerësuar të mjeteve të luundshme.

1.3. Data e ankandit publik:
Ankandi publik për shitje të mjeteve të luundshme nga pika 1 do të realizohet në mënyrë elektronike më 22.2.2019, me fillim në ora 12.00.

II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik kanë të gjithë subjektet e vendit dhë të huaj fizikë dhë juridikë që mund të kërë të drejtën e pronësisë së mjeteve të luundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK

Paraqitja për pjesëmarrje në ankandin publik bëhët në mënyrë elektronike në internet faqen në vijim:
e-aukcii.finance.gov.mk
Të bashkëngjitur, parashtrueësi duhët të dorëzojë:

Garanci bankare për sërcozitet të ofertës në shumë prej 2% të shumës së vlerësuar të mjeteve të luundshme në shumë prej 1.230,00 denarë me afat valid prej 60 ditëve nga dita e lëshimit.

si dhë:

a) **Për subjektet juridike**
- Gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht dokument përkatës të dëshmë nga organi kompetent nga vendi ku âshtë i regjistruar subjekti juridik jo më lë vjetër se 6 muaj nga dita e lëshimit.

b) **Për subjektet fizikë**
- Kopjë të leksnjëftimit valid osë dokumentit të udhëtimit.

Garancia bankare për sërcozitet të ofertës në shumë prej 1.230,00 denarë, gjegjësisht 2% të shumës së vlerësuar të mjeteve të luundshme dërë në skudëmë e afatit për paraqitje parashtrohet në formë me shkrim (në original) **dërë te Komisioni për posedim të mjeteve të patundshme dhë mjeteve të luundshme pronë e Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë – Sekretariati i përgjithshëm në adresën: bul. "Ilinden" nr. 2, Shkup, me shenjë në çarf "MOS HAP".**

IV. AFATI PËR PARAQITJE

Për pjesëmarrje në ankandin publik, pjesëmarrësi obligohët që të paraqitë në mënyrë elektronike derë në kulmin e ditës së dytë, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljës në gazetat ditorë dhë në internet faqen, gjegjësisë derë më 15.2.2019.

Komisioni parashtrueësve që në sistemë për ankand publik elektronik jasë (paraqitur me kompletë dokumentë të bashkëngjitur, të lëvizëshëm në çfarë, të shpaëjë, në afat prej tre ditëve pas kulmit të kohëzgjatjës së shpalljës do t'u dërgojë emër përdoruës dhë fjalëkalë për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtrueësve të fitëëpaëqitjëve që duë kanë dërë dokumentë do t'u dërgojë njëmëndimë argëtëm se duë do të marrë pjesë në ankandin publik.

V. MËNYRA DHE PROCEDURA PËR REALIZIM TË ANKANDIT PUBLIK

1. Ankandi publik realizohet në pajtim me dispozitat në nenin 26, neniin 48 dhë nenin 49 t'Ligjit për shfrytëzim dhë disponim të mjeteve të pronësë shtetërorë dhë me mjetet në pronësë komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15, 21/18).
2. Çdë të mbahet ankandi publik, është e nevojshme të kërë në çaku një paëdëmandës.
3. Për ofertuës me të vërtetë dë ankandit publik, llogaritet paëdëmandësi çdë e ka ëhumë pranë e fundit, i cili përfaqësohët nëmëndimë më të lartë për shitje të tenderëve të luundshme.
4. Ofertuës më i vërtetë dë fitë i dëfinuar çë në afat prej 15 ditëve nga ëhumë i njoftë me letër për njëëdhë. Ë paguëë mjetet në pajtim me çmimë e arritur përfundëtë të ankandit, në të kundërtë nuk çë të çëë nëë llogë së mëëmëëshëës, ndërsa garanca bankare për sërcozitë të ofertës do të ëëëëëhët dhë ofertuësi nuk do të mund të marë pjesë në çdë ankand të andhëëm publik për vendë e luundshëm në periudhën prej 1 viti.
5. Bankës i së drejtës në pronësë do t'ë ëëh mëëëëëëëëëë për shitje bëëë me ofertuësë më të vërtetë dë afat prej 15 ditëë të punës pas paëëëëëë së realizuar në çmimë e aëëëëë të luundshëëë.
6. Pjesëëëëëëëë e ankandit publik kë dë drëë ë ëëë vëëëë ë ëëë me procedurën për ankandë publik. Ëëë ëëëëëëëë dë ë Komisioni ë afat prej 3 ëëëë nga dë e ëëëëëë ë ëëëëëë ë ëëëëëë. Komisioni ëëëëë ë ëëë ëëëëë ë afat prej 8 ëëëë ëë ëëëëëë ë ëëëëë. Kundër vendimit të Komisionit mund të deklarohet ankesë dë Komisioni shënë ëë vendosë në procedurën administrative dhë procedurën për marrëëëëëë e punës në shkallë të dytë.

VI. INTERNET FAQJA NË TË CILËN DO TË MBAHET ANKANDI PUBLIK

Ankandi publik do të realizohet në mënyrë elektronike në internet faqen në vijë:
e-aukcii.finance.gov.mk

Komisioni për posedim të mjeteve të patundshme dhë mjeteve të luundshme të Republikës së Maqedonisë

ALEKSANDER CEFERIN RIZGJIDHET PRESIDENT I UEFA-s

"Futbolli evropian duhet të mbetet respektues, i respektuar dhe i nderuar. Falemnderit sërish që më besuat. Jam i emocionuar dhe i nderuar njëkohësisht", tha Ceferin

Aleksander Ceferin rizgjidhet në krye të UEFA-s për një mandate tjetër katërvjeçar në gjatë punimeve të Kongresit të 43-të të Zakonshëm të UEFA-s në Romë. 51-vjeçari slloven, i cili u zgjodh presidenti i shtatë i UEFA-s në shtator të vitit 2016 pas largimit të francezit Michel Platini, u konfirmua me votë unanime këtë të enjte, nga delegatët e 55 federatave anëtare të UEFA-s Ai u zotua se "uniteti, shpresa, respekti dhe solidariteti" do të ishin elementët kyç në strategjinë, misionin dhe aktivitetet e UEFA-s gjatë mandatit të ri presidencial të tij. "Futbolli evropian duhet të mbetet respektues, i respektuar dhe i nderuar. Falemnderit sërish që më besuat. Jam i emocionuar dhe i nderuar njëkohësisht", tha Ceferin. Ceferin këmbënguli se, pavarësisht sukseseve të fundit dhe zhvillimeve pozitive, veçanërisht në lidhje me frymën e unitetit që ka mbizotëruar anembanë futbollit europian, UEFA nuk do të heqë dorë nga përmbushja e rolit të saj si trupa qeverisëse e futbollit në kontinentin e vjetër. Presidenti i UEFA-s ritheksoi statusin e rëndësishëm të turneve madhore për ekipet kombëtare në Europë, si Europiani apo Liga e Kombeve, me këtë të fundit që ofron garanci për sukses, ndërsa "Euro 2020", që do të zhvillohet në 12 qytete në mbarë Europën gjatë verës së ardhshme, do të japë një mesazh të fuqishëm jo vetëm për të apasionuarit pas futbollit, por edhe Europës si e tërë: mesazhin për një kontinent të hapur, tolerant dhe të bashkuar!

Publicitet

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësinor

[redacted]

Drejtori i NP "Kamena reka" M. Kamenicë publikon:

Shpallje publike nr. 1/2019

Për punësim të 3 (tre) ofruesve të shërbimeve publike për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

1. KDR 03 05 V02 001 – Punëtor i përgjithshëm komunal – 2 (dy) realizues
2. KDR 03 05 B04 041 – Kopshtar - 1 (një) realizues

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i RM
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushtet e posaçme:
1.për vendin e punës me numër rendor 1 – arsim fillor të mbaruar
2.për vendin e punës me numër rendor 2 – niveli i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar arsim të mbaruar katërvjeçar

Orari i kohës së punës:
- Lloji i punësimit: koha e pacaktuar
- Ditët e punës: e hënë – e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë
- Orari i punës: ora 07:00 deri 15:00
- Shuma në të holla e pagesës fillestare:

1.për vendin e punës me numër rendor 1 - 12.127,00 denarë
2.për vendin e punës me numër rendor 2 - 12.969,00 denarë

Vërejtje: Me kandidatët realizohet intervistë. Kandidati i cili ka dhënë informata jo të sakta në fletëparaqitje diskualifikohet në procedurën e mëtutjeshme. Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Shpallja publike zgjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe fillon të rrjedhë nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 10 (dhjetë) ditëve. Formulari i fletëparaqitjes për punësim merret nga Arkivi i NP Kamena reka M. Kamenicë. Fletëparaqitja me dokumentet e nevojshme të parashtrohet deri në NP Kamena reka M. Kamenicë, rr. "Rudarska" nr. 7 në Makedonska Kamenicë.

NP Kamena reka M. Kamenicë

Në bazë të nenit 19 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënësit e shkollave të mesme, SHMK "Kiro Spanxhov-Brko" Kavadar, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
për grumbullim të ofertave për organizim të ekskursionit përfundimtar

1. Ekskursion përfundimtar për minimum 40 persona në relacionin Budapest - Pragë - Dresden - Vjenë për periudhën prej 5 ditëve me 3 bujtje në muajin prill të vitit 2019.
2. Dokumentacioni tenderues dhe programi për realizim të ekskursionit mund të tërhiqet në arkivin e shkollës çdo ditë pune nga ora 07-15 ose të parashtrohet në e-mail.
3. Shpallja publike zgjat 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.
4. Informata më të hollësishme në tel. 043 412-847

SHMK "Kiro Spanxhov-Brko" Kavadar
Rr. "Shishka" pn

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 145/2015 –teksti i pastruar) dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor, pëlqimit të MASH nr. 12-899/1, drejtori i SHFK "Murat Llabunishti" nga Llabunishta më datë 06.02.2019 ka sjellë vendimin për publikim

Shpallje publike
Për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2019 për vitin shkollor 2018/19 për vendet e punës në vijim:

1. **Katër mësimdhënës** për mësimin **klasor: tre** për mësimin në gjuhën shqipe prej të cilëve një – zëvendësim për vendin e drejtorit dhe **një** për mësim në gjuhën maqedonase.
2. **Tre mësimdhënës të gjuhës angleze – dy** mësimdhënës **të gjuhës angleze** për mësimin në gjuhën shqipe me orar të plotë të punës dhe **një** për mësimin në gjuhën maqedonase si zëvendësim të punëtorit që mungon që është në pushim të lindjes.
3. **Dy mësimdhënës të gjuhës gjermane** prej të cilëve **një** për mësimin në gjuhën maqedonase me orar të plotë të punës dhe **një** me orar jo të plotë prej 10 orëve mësimore për mësimin në gjuhën shqipe.
4. **Një mësimdhënës të artit figurativ** për mësimin në gjuhën shqipe me orar jo të plotë të punës – 12 orë mësimore.
5. **Një mësimdhënës të historisë** me orar të plotë të punës për mësimin në gjuhën shqipe.
6. **Tre mësimdhënës të matematikës** për mësimin në gjuhën shqipe prej të cilëve një mësimdhënës me orar të plotë të punës ndërsa dy me orar jo të plotë – 10 orë mësimore për mësimin në gjuhën shqipe.
7. **Një mësimdhënës të informatikës dhe projekteve të informatikës** për mësimin në gjuhën shqipe me orar të plotë të punës.
8. **Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase** me orar të plotë të punës.
9. **Një mësimdhënës të gjeografisë** për mësimin në gjuhën shqipe me orar të plotë të punës si zëvendësim për personin e emëruar.
10. **Një mësimdhënës të biologjisë** me orar të plotë të punës për mësimin në gjuhën shqipe.
11. **Një mësimdhënës të edukatës fizike dhe shëndetësore** për mësimin në gjuhën maqedonase me orar të plotë të punës.
12. **Një defektolog**

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme me ligj dhe kushtet e posaçme sipas nenit 80 të Ligjit për arsim fillor dhe Normativin për kuadrin mësimor. Kusht plotësues është njohja e gjuhës dhe alfabetit në të cilin realizohet mësimi, për çka kandidatët enkas do të informohen për ditën e testimit. Së bashku me **lutjen** kandiodatët duhet të parashtrojnë: **diplomë** ose **certifikatë** për arsim të mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, **certifikatë të shtetsisë.** Orari i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte me ndërrime dhe fillon – ndërrimi i parë prej ora 7,30 deri në ora 13,15 dhe prej ora 12 deri në ora 18.30 për ndërrimin e dytë, në pajtim me programin vjetor për punë të shkollës. Për për defektologun orari i punës është prej ora 08,00 deri në ora 16,00.

Pagesa themelore për mësimdhënësit me orar të plotë të punës është 20.640 den., ndërsa për orar jo të plotë të punës në përpjestim me numrin e orëve. Shpallja do të jetë e hapur 5 ditë pune nga dita e publikimit. Vendimi për zgjedhje do të realizohet më së voni deri në 15 ditë nga dita e përfundimit të shpalljes. Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri në SHFK "Murat Llabunishti" – Llabunishtë.

SHFK "Murat Llabunishti" nga Llabunishta
Drejtor,
Valon Mamudi
Llabunishta

MARTINEZ: I SHPJEGOVA SPALLETIT SE BABAI IM KA QENË FUTBOLLIST

"Midis meje dhe trajnerit çdo gjë është në rregull. I shpjegova Spallettit se babai im ka qenë futbollist, ka lindur në një "dhomë zhveshjeje". Ne jemi një familje me pasion. Babai im e kishte gabim, kur shkroi atë "tweet" të famshme", ka deklaruar Martinez

Goli vendimtar në ndeshjen Inter-Napoli dukej se do të shënonte një pikë kthese të sezonit të Lautaro Martinez. Megjithatë, sulmuesi i ri argjentinas ishte protagonist negativ me penalltinë e humbur kundër Lazios, në Kupën e Italisë. Në një intervistë të gjatë me "La Nacion", Martinez përpiqet të shpjegojë vështirësitë e hasura në Itali: "Kam ardhur këtu vetëm 20 vjeç, në një vend që ndryshon shumë nga Argjentina. Dhe kjo është e rëndësishme. Këtu flasim një gjuhë tjetër, jetoj në një mënyrë të ndryshme dhe duhet ta integroj veten. Tifozët dhe njerëzit e klubit më ndihmojnë shumë. Jam në një klub të madh, me kaq shumë lojtarë të mëdhenj, në një sulm të madh. Punoj çdo ditë që të kem një vend në ekip. Stërvitem në të njëjtën mënyrë, edhe në qoftë se nuk do të luaj", ka deklaruar Martinez. Vetëm Mauro Icardi, kapiten dhe bashkatdhetar i Lautaro Martinez, e mori menjëherë sulmuesin e ri nën mbrojtje. "Ai më ndihmoi shumë me kërkimin e banesës në Milano. Më ka ndihmuar edhe të bëj pazar, të kuptoj disa zakone. Mauro është vënë menjëherë në dispozicion tim. Ne kemi një raport shumë të mirë, brenda dhe jashtë fushe", shtoi sulmuesi argjentinas.Pak më shumë probleme ka pasur me Spalletin, edhe për shkak të një "tweet" jo shumë të mirë me trajnerin zikaltër nga babai i Lautaro Martinez: "Midis meje dhe trajnerit çdo gjë është në rregull. I shpjegova Spallettit se babai im ka qenë futbollist, ka lindur në një "dhomë zhveshjeje". Ne jemi një familje me pasion. Babai im e kishte gabim, kur shkroi atë "tweet" të famshme. Eshtë njerëzore, sepse ai ka reaguar për djalin e tij, por gjithçka është mirë. Unë stërvitem dhe pres momentin tim", ka theksuar Martinez. Së fundi, Lautaro Martinez siguron se Interi ka qenë gjithmonë zgjedhja e tij e parë dhe e vetme, duke mohuar kontaktet me Betisin: "Nuk dija asgjë, nga lajmet që lexova, e mora vesh këtë gjë. Presidenti i Betis më pyeti për situatën që po kaloj në Milano, por askush nuk më tha asgjë më tepër. Kam menduar gjithmonë për Interin, jam shumë i lumtur këtu. Përpiqem të përfitoj nga mundësitë, që trajneri më jep, për të arritur objektivat".



Drama e futbollistit Al-Araibi, mbahet në burg në Tajlandë

Vazhdon kalvari i vuajtjeve për futbollistin nga Bahreini Hakeem Al-Araibi, i cili është arrestuar në vitin 2018 me akuzën se ka dëmtuar një stacion policie në vendin e tij gjatë kohës së pranverës arabe. Autoritetet tailandeze, ku dhe po mbahet aktualisht 25-vjeçari, kanë vendosur që Al-Araibi nuk mund lirohet, pasi duhet të plotësohen të gjithë dokumentacionet e nevojshme në lidhje me kërkesën për ekstradim nga ana e autoriteteve të Bahreinit. Kështu, lojtari nuk do të mund të rikthehet në shtëpinë e tij në Australi, vend në të cilin prej 4 vitesh gëzonte statusin e refugjatit politik, përpara se të arrestohej nga interpoli nëntorin e vitit të kaluar në aeroportin e Bankokut, vend në të cilin kishte udhëtuar për muaj mjalti. Për rastin në fjalë ka ndërhyrë edhe qeveria australiane, që po përpiqet maksimalisht për ta ndihmuar Al-Araibin. Ndërkohë futbollisti ka një alibi të fortë në duart e tij, ditën që është vënë në pranga ai ka qenë duke luajtur futboll e për më tepër ndeshja është transmetuar "live". Gjyqtari që e ka dënuar 25-vjeçarin është anëtar i familjes mbretërore të sheikut Salman bin Ebrahim Al Khalifa. Ndaj këtij të fundit Al-Araibi është shfaqur kritik. Ministrja e Jashtme e Australisë, Maris Pein, ka deklaruar se qeveria e saj i bën apel autoriteteve tailandeze të lirojë lojtarin. Përpara gjykatës, Al-Araibi është shfaqur me këmbët zbathur dhe të lidhura me zinxhir, teksa ka bërtitur në sallë që të mos dërgohet në Bahrein. Për rastin në fjalë ka reaguar edhe mbrojtësi i Juventusit, Giorgio Chiellini, i cili përmes një statusi në Twitter ka kërkuar që 25-vjeçari të rikthehet sa më shpejt në Australi. Ndaj Al-Araibit ka nisur dhe një fushatë në rrjetet sociale me hashtagun "shpëtoni Hakimin".

Kluivert injoron Messin dhe Ronaldon

Trajneri aktual i Kamerunit, Patrick Kluivert, ka thënë në një intervistë për "360 Sport" se ka shumë admirim për kampionin e ri botëror, Kylian Mbappé. Madje, ish-sulmuesi i njohur holandez konstaton cilësi të përsosura te 20-vjeçari, që të jetë golashënuesi më i mirë sot për sot. Ish-lojtari i Ajax, Milan, Barcelona dhe PSV tregon se cilat janë kërkesat themelore për të qenë një golashënues i madh: "Shënimi i golave është 70% instinkt natyror, 30% të tjera lidhen me të mësuarit në stërvitje, si dhe mënyrën e orientimit në fushë, ku e kërkoni topin, ose si komunikoni me shokët". Edhe pse Kluivert e pozicionon Mbappé në vendin e parë, ai, gjithashtu, ka nënvizuar sulmues të tjerë të mëdhenj, si Marcus Rashford dhe Aubameyang. Në rastin e Rashford, holandezi guxon ta rekomandojë atë si një zëvendësues të mundshëm për Luis Suárez te Barcelona, duke iu referuar shpejtësisë dhe lehtësisë së tij në shënimin e golave. Ndërsa Leo Messi dhe Cristiano Ronaldo janë pothuajse çdo javë duke e dërguar topin në rrjetë, Kylian Mbappé është lojtari më i rëndësishëm në këtë "shkallëzim", sipas holandezit.

"Për mua, golashënuesi më i mirë sot për sot është Mbappe", pohon Kluivert, për të cilin francezi i ka të gjitha cilësitë për t'u kurorëzuar si golashënuesi më i mirë i futbollit aktualisht. Kylian Mbappé u bë lojtari më i ri, që shënon tetë gola në Champions, me vetëm 18 vite e nëntë muaj mbi supe, një shifër që Messi e arriti në moshën 20 vjeç e shtatë muaj. Aktualisht, talenti francez ka 18 gola në Ligue 1 dhe 3 gola në Champions.

Presidenti i Milanit përsërit rëndësinë e Gattusos

Lëndimet e shumta në pjesën e parë të sezonit, eliminimi nga "Europa League" që në fazën e grupeve dhe polemikat e vazhdueshme në lidhje me rastin "Higuain". Gennaro Gattuso, këtë sezon, shpesh e ka gjetur veten përballë momentesh delikate, madje duke rrezikuar që të largohet nga stoli i skuadrës, fanellën e së cilës e ka veshur gjatë viteve. Pas startit disi të errët të sezonit, Milani ka arritur të ketë një paraqitje pozitive në fillim të vitit 2019, çka iu ka lejuar kuqezinjve të ngjiten deri në vendin e katërt të Serie A. Më tepër se kaq, skuadra e Gattusos e ka reduktuar në vetëm katër pikë distancën nga Interi i vendit të tretë, duke u kualifikuar edhe në gjysmëfinale të Kupës së Italisë, pasi eliminoi së fundi Napolin e Carlo Ancelottit në "San Siro". Këto rezultate të rëndësishme thuhet se e kanë "votëbesuar" Gattuson në stolin e Milanit, me ish-mesfushorin kuqezi që konsiderohet nga klubi një nga arkitektët kryesorë të kësaj rilindjeje. Sipas "La Gazzetta dello Sport", Gattuso do mbi të gjitha të fitojë besimin e presidentit Paolo Scaroni, i gatshëm për ta konfirmuar në fund të sezonit, nëse provat janë të vijueshme. "Jam i kënaqur me klimën, që është krijuar në Milano, e cila përfshin lojtarët e rinj dhe ata që ishin nën urdhrat e Rino. E çmoj shumë karakterin që kishte Gattuso për të luajtur në fushë, por edhe tani si trajner. Ai ka qenë në gjendje t'i ketë lojtarët në anën e tij, të mposhtë vështirësitë e lëndimeve dhe të gjitha pengesat e tjera. Ne i detyrohemi shumë", thotë presidenti kuqezi. Është e qartë se trajnerit Gattuso i njihen meritat për "rilindjen" e portierit Donnarumma, të rritjes së Kalabria dhe Cutrone, përveç "ringjalljes" së Bakayoko, që tani është pikë referimi në mesfushën kuqezi. Qëndrueshmëria e re mbrojtëse dhe "pjelloria" e menjëhershme në sulm, pas arritjes së Piatek dhe Paqueta, e kanë bërë Milanin më kompetitiv. Natyrisht, kjo është meritë e Gattusos, që tani, në mënyrë të vendosur, drejton një grup lojtarësh plot shëndet dhe entuziasëm.

DASHI — 21. mars - 20. prill

Nervozizmi do të dominojë gjithë këtë ditë, për shkak të ndikimit negativ të Venusit. Reflektoni dhe bëni zgjedhjet e duhura, duke dëgjuar këshillat e vlefshme që do ju japin.

DEMI — 21. prill - 21. maj

Të lindurit e kësaj shenje i pret një ditë e mbushur me momente tensioni. Qetësia dhe diplomacia, do ju lejojnë që të menaxhoni më mirë situatat kritike me të cilat do të përballeni.

BINJAKET — 22. maj - 21. qershor

Do të jeni të karakterizuar nga një lloj lodhjeje fizike dhe psikologjike. Bëni kujdes maksimal, për gjërat që kanë vërtetë rëndësi për ju.

GAFORRJA — 22. qershor - 22. korrik

Këshillohet që të jeni më shumë të përqendruar në sferën profesionale. Në sferën e ndjenjave mund të përballeni me disa probleme. Po ashtu nuk përjashtohen disa zgjidhje drastike.

LUANI — 23. korrik - 22. gusht

Gjatë kësaj të enjteje bëni mirë që të qëndroni sa më larg konflikteve dhe tensioneve në të gjithë sektorët. Kjo nuk është aspak një ditë pozitive.

VIRGJERESHA — 23. gusht - 23. shtator

Do të jetë një ditë pozitive në çdo drejtim. Suksesi dhe arritja e objektivave të rëndësishëm, do të shoqërojnë gjithë të lindurit e kësaj shenje.

PESHORJA — 24. shtator - 23. tetor

Kjo ditë nuk është një prej më të favorshmet, pasi ka ende prani ndikimesh negative nga ana e yjeve. Sugjerohet që gjatë kësaj të enjteje, të përqendroheni maksimalisht në sferën sentimentale.

AKREPI — 24. tetor - 22. nëntor

Parashikohet një ditë e mbushur me luhatje humori në çdo sektor. Rigjetja e qetësisë do të jetë e domosdoshme për të përballuar një periudhë teranzitore.

SHIGJETARI — 23. nëntor - 21. dhjetor

Të lindurit e kësaj shenje duhet të gjejnë forcat dhe energjinë për t'iu përkushtuar më shumë sferës profesionale, shkruan noa.al. Parashikohen momente kritike, sidomos sa i takon dashurisë.

BRICJAPI — 22. dhjetor - 20. janar

Parashikohet një e enjte e mbushur plotë me pozitivitet dhe situata të favorshme. Yjet do ju ndriçojnë rrugën, duke favorizuar çdo drejtim tuajin.

UJORI — 21. janar - 19. shkurt

Duhet të përkushtoheni më shumë në sferën sentimentale, për të kaluar disa situata kritike. Gjatë kësaj të enjteje duhet të përqendroheni në rikuperimin e energjive.

PESHQIT — 20. shkurt - 20. mars

Do ju duhet që të jeni më shumë të përqendruar në sferën profesionale, duke lënë mënjanë një moment të vështirë të jetës sentimentale. Vetëm në këtë mënyrë do arrini që të ngrini kryer.

KOHA	1000 ROMAK	JO RELATIV	JO ÇIFT	**KOHA**	METRI / B. Ë.		NË KËTË KOHË, TANI / FABRIKË ITALIANE AUTOMOBILASH			
PËRFUNDIM NË SHAH				LLOJ BIME, PAZI / PJESË TË TRUPIT					TEMPO / AVIO KOMPANIA E ISH JUGOSLLAVISË	
FILIZI	ALEANCË / I SYHAPURI, I SHKATHTI									
B					VEGLAT SHKRIFTUESE TË LESHIT / KËNG%TARI I LASHTË SEMIT					
SISTEMI OPERATIV / AUTORI FRËNG NË FOTO			VJERSHËTORET / VAHIT NASUFI							KRYEN DIÇKA, KRIJON
ZH							TAUTOLOGJIA / ZOTËRI (GJERM.)		BELGJIKA / ELEMENT KIMIK	
AKTORI KOSOVAR, LAJÇI				VEPËR E AUT NË FOTO, "NGA TOKA ..." / AUTORI FRËNG, EMIL						
FILM I SPILBERGUT (I TI)			EMRI I ZIDANIT / GRUP I ORGANIZUAR KËNGËTARËSH							
LITRI / ISH KRYETARI RUMUN, ÇAUSHESKU		METEOR JOMETALIK / KUMANOVA								PARTIA DEMOKRATIKE
N							ARMË E RËNDË ZJARRI / REOMIRI			
KOHA	NDËRTIMI MBI LUMË				TUND, LËKUND					

Mensur Mamuti	AKTORI AMERIKAN, ARON	AKTORI ITAL. LINO / VEPËR E AUTORIT NË FOTO, "RRETH BOTËS ..."	V	RESPEKT
PËRKULEN, LAKOHEN				
QOSHE				
VEPRIMTARI ARTISTIKE (SH. PASHQ.) / PUBLICISTI, ZHEJI				
A				
THAJ / VEPËR E AUTORIT NË FOTO, "20 MIJË.."				VATAN

ZGJIDHJET: V, EPEN, KËND, ARTE, ARTUR, TËR, M, TASH, MAT, BIFË, T, BESËLIDHJE, BISKU, JAJAT, SO, POETET, ZHYL VERN, T, B, ÇUN, NE HENE, ET, ZINEDIN, L, KONDRIT, NIKOLAE, TOP, URA, TRËND.

Sudoku

I lehtë

5			4		1			6
	4		3		9		8	
2				6				9
1	2						9	3
		3				2		
4	6						5	8
3				5				2
	1		6		3		4	
9			7		2			1

Mesatar

	2							
								6
7		4	9	6				5
		3	5				4	9
8				3			7	
	5							2
	3	7				6		
1				5				
2			7				1	4

Shumë i lehtë

5			4		1			6
	4		3		9		8	
2				6				9
1	2						9	3
		3				2		
4	6						5	8
3				5				2
	1		6		3		4	
9			7		2			1

Mesatar

	2							
								6
7		4	9	6				5
		3	5				4	9
8				3			7	
	5							2
	3	7				6		
1				5				
2			7				1	4

Shumë i lehtë: 598471326, 641329587, 237568419, 125846793, 873915264, 469237158, 386154972, 712693845, 954782631. **Mesatar:** 526348197, 319275486, 784961235, 673512849, 892436571, 451897362, 937124658, 148659723, 265783914.

BIZNES ME QUMËSHTIN E DEVESË



Qumështi i devesë po shitet si superushqim në supermarketet amerikane e ato britanike, apo edhe "online" përmes faqeve si "Amazon", e kërkesa për të sa vjen e shtohet. Interesi është i madh si për qumështin e freskët, ashtu dhe për produkte që bëhen prej tij, përfshirë çokollatat, disa lloje djathërash, akulloret dhe kremat e lëkurës. Nga ana tjetër, deri edhe kockat e deveve të ngordhura gjejnë përdorim, pasi kthehen në suvenire për turistët. Hitesh Rathi në Indi, një investitor në këtë treg, thotë se biznesi i tij trevjeçar kërkon deri në 7.000 litra qumësht deveje në muaj. "Tregu dhe kërkesa për qumështin e devesë e produkte të lidhura me të po rriten me hapa të shpejtë. Megjithatë, sfidat nuk janë të vogla, si kur flitet për ndërgjegjësimin mbi këto produkte, ashtu dhe për marketimin e linjës së mallrave tona", tha Hitesh Rathi, biznes. Ky lloj qumështi po shihet me kureshtje të shtuar në perëndim, por në Indinë me shumicë hinduiste, ku adhurohen lopët dhe qumështi i tyre lidhet si me nevojat ushqimore, ashtu edhe me besimin, ai i devesë shitet më me vështirësi.

Përpos kësaj, ai vjen më i yndyrshëm dhe pak më i kripur në shije, e jo të gjithë janë mësuar me të. Por, shenjat pozitive nuk mungojnë. Shpresat janë që një treg i tillë të rritet dhe komunitete tradicionale të kenë një nxitje ekonomike për të shtuar tufat e tyre të deveve, numri i të cilave po vjen në rënie.

Gjendet zona e trurit që na bën të qeshim

Të qeshurat me të vërtetë janë ilaçi më i mirë. Kjo vlen edhe për operacione të trurit pasi ndihmon në qetësimin e pacientit, sipas një studimi të ri. Gjatë operimeve delikate të trurit ku pacienti është i zgjuar, nëse ata janë në panik dhe fillojnë të lëvizin mund të jetë kërcënuese për jetën. Por neurokirurgët amerikanë kanë gjetur një mënyrë për të gudulisur një zonë të trurit në mënyrë elektronike, për të nxitur qeshjen e menjëhershme të ndjekur nga një ndjenjë e qetësisë dhe lumturisë.

Kjo teknikë është një mënyrë "potencialisht transformuese" për qetësimin e disa pacientëve gjatë operimeve të trurit ku duhet të qëndrojnë të zgjuar. Për mbrojtje optimale të funksioneve kritike të trurit gjatë operacionit, pacientët mund të kenë nevojë të jenë të zgjuar dhe jo të mpirë, kështu që kirurgët mund të flasin me ta, të vlerësojnë aftësitë e tyre gjuhësore dhe të zbulojnë dëmtime që mund të lindin nga resektimi. Teknika që redukton ankthin mund të përdoret gjithashtu për të trajtuar depresionin ose dhimbjet kronike.

270 Marilyn Monroe

Fansat e ikonës se bukurisë, Marilyn Monroe kanë hyrë në librin Guinness. Mbi 270 gra por edhe burra u veshën si biondja, që mbetet një nga femrat seks simbol më të njohura e të gjitha kohërave. Ata vendosën paruke dhe realizuan make up in për tu dukur sa më të ngjashëm me Marilyn , sigurisht pa harruar edhe fustanin e bardhë. Më pas fansat u zhytën në det në plazhin Brighan, ku zhvilluan një garë noti. Aktiviteti që organizohet prej disa vitesh ka si qëllim mbledhjen e të ardhurave që do të shkojnë për kërkime në mjekësi për të gjetur kurën për shërimin e kancerit. Kjo arrihet përmes shitjes së parukeve dhe deri tani janë mbledhur 65 mijë Dollarë, por synimi është që shifra të shkojë deri në 100 mijë. Aktiviteti u ndoq nga mijëra persona, të cilët i kanë mbijetuar sëmundjes së rëndë apo janë duke u kuruar. Organizatorët thanë se kërkesat ishin të shumta, por jo të gjithë ja dolën.

"Nuk dua të vdes me para në bankë", pronari i paguan shkollën fëmijëve te punëtorëve të tij

Pronari nuk është figura më e pëlqyer për punëtorin, por ndryshon rasti nëse jemi duke folur për 80-vjeçarin Vinicio Bulla. Vinicio është një biznesmen nga Caltrano, provincë e Italisë me rreth 2500 banorë dhe është pronar i kompanisë "Rivit Spa" me të cilën prodhon çelik special. Çeliku i prodhuar nga kompania e Vinicios përdoret në platforma nafte në të gjithë botën. Por, 80-vjeçari Vinicio ka vendosur që pasurinë e tij të mos e "ndryshkë" në banka. "Nuk dua të vdes me para në bankë. Dua të ndihmoj ata që kam pranë!", tha ai për Il Messaggero. Kështu, italiani u ka ofruar 150 punëtorëve të tij ndihmesë për pagesën e shkollimit të fëmijëve të tyre. Me vendim të vetë Vinicios, pasuria e tij është ngrirë në bankë dhe ai paguan rreth 6600 euro në vit për shkollimin e çdo fëmije të punëtorëve të tij, duke nisur që nga çerdhja, kopshti e deri në universitet.

KALENDARI HISTORIK 8 SHKURT

421 - Flavius Konstantini emërohet Parandori Konstantini III i Perandorisë Romake Perëndimore.

1600 - Vatikani dënon dijetarin Xhordano Bruno me vdekje.

1601 - Ushtria e Earl Robert Devereux futet në Londër.

1807 - Napoleoni mund rusët në betejën e Ejlaut.

1809 - Franci I i Austrisë i shpall luftë Francës.

1904 - Fillon lufta ruso-japoneze.

1909 - Franca dhe Gjermania nënshkruajnë traktat në lidhje me Marokon.

1920 - Burrat zviceran votojnë kundër të drejtës së grave për votë.

1926 - Formohen studiot e Ualt Diznit.

1952 - Elizabeta II shpallet Mbretëreshë e Britanisë së Madhe.

1994 - Xhek Nikollsoni përdor shkop të golfit për të sulmuar një veturë.

2005 - Izraeli dhe Palestina pajtohen për armëpushim.

A E DINI SE...

TRURI I FEMRËS PLAKET MË NGADALË SE TRURI I MESHKUJVE

Truri i femrës plaket më ngadalë dhe mesatarisht është të paktën tre vjet më i ri se truri i bashkëmoshatarëve meshkuj. Ky është zbulimi i fundit nga Universiteti i Washington në St Louis dhe i publikuar në revistën e Akademisë Amerikane të Shkencave PNAS.



Kështu gratë janë gjithnjë më të reja në terma biologjikë, ose të paktën i tillë është truri i tyre. Ky rezultat mund të shpjegojë edhe faktin se në moshë të avancuar gratë, përsa i përket arsyetimit, memories, zgjidhjes së problemeve janë më të shëndetshme mendërisht se meshkujt e të njëjtës moshë. Ndryshimi qëndron në mekanizmat e metabolizmit cerebral, pra mënyra se si truri konsumon sheqernat me kalimin e moshës. Nga eksperimentet e kryera ka rezultuar se duke nisur nga mosha 20 e sipër, truri i femrës është 3.8 vjet më i ri se ai i mashkullit. Analizat janë kryer mbi të dyja gjinitë dhe me anë të rezonancës magnetike rezultati ka qenë i njëjtë. Diferenca është domethënëse dhe studimet do të vijojnë në këtë drejtim.

THËNIA E DITËS

Kush jeton sipas të gjitha rregullave, humb gjithë kënaqësitë.
(Katherine Heyburn)